# Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik “Mbi draftin e Programit Buxhetior Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025” të Këshillit Bashkiak Shkodër

**Titulli i Projekt-aktit** : “Mbi draftin e Programit Buxhetior Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025”

**Grupet që u konsultuan:** Banorët e Lagjeve 1,2,3,4,5, Banorët e të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqsues të grupeve të ndryshme te interesit, etj.

**Numri i pjesëmarrësve në konsultime :** 488 persona, nga të cilët 97 gra dhe vajza (20%)

**Numri i rekomandimeve: 462**

Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimet publike janë mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, kopshteve cerdheve,
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore,
- Përmirësimin e shërbimeve publike ujësjellës kanalizime, menaxhimi i mbetjeve, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit public
- Pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse
- Shtimi i hapësirave rekreative për të rinjtë
- Përmirësimi i transportit urban dhe lidhja e tij me rrjetin rural
- Shërbimet ne favor të bizneseve që punojne për turizmin

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web dhe facebook të Këshillit Bashkiak.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

# PËR

# "DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".

**Konsultim publik :** Njësia administrative Dajç.

**Data :** *16.09.2024* **Ora** : *13.00* **Vendi:** Pranë Komunës

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 30, nga të cilat 5 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Zv/Kryetari i Bashkisw Z.Onid Bejleri i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr Z. **Fred Macorri,** Kryetari i fshatit Pentar i cili shprehet se:

- Ka nevojë të bëhet pastrimi i kanaleve në zonën e Pentarit.
- Sistemim i rrjetit të OSHEE është i amortizuar shumë.

**Banor,** fshati Shirq thotë se:

- Shkolla e fashtit ka problematika të ndryshme të infrastrukturës,

- Duhet të ndahet oborri i shkollës nga qendra shëndetsore.

**Kryeplaku**, i fshatit Darragjat shpreh shqetësimet e tij:

- Është e nevojshme vendosja e ndriçimit publik në rrugën e Darragjatit.
- Gjithashtu një pjesë rruge ka mbetur e papërfunduar.

**Z.Hamdi Mlloja,** banor fshati Mushan thotë se:

- Kemi kërkuar disa herë për shtrimin e një rruge në Mushan, e cila lidh me shkollën dhe me qendrën shëndetësore.
- Ka nevojë për vendosjen e ndriçimit në këtë rrugë.
- Duhen pastruar edhe kanalet kulluese të Mushanit.
- Duhet të bëhet pastrimi i kanalit vaditës, pasi shërben edhe si kanal kullues për fshatin.

**Z.Tom Pjetrani ,** kryetar fshati Samrisht shprehet se:

- Mungon uji i pijshëm në fshat.
- Kanalet e dyta dhe të treta janë të papastruara.
- Gjithashtu edhe rruga e fshatit ka nevojë për ndërhyrje.
- Rrjeti i OSHEE është shumë I amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje.

**Kryetari i fshatit Shirq,** merr falën dhe thotë:

- Kemi rrugë të shkurta të cilat duhet të rikualifikohe.
- Rruga që lidh kishën e fshatit Shirq duhet të bëhet duke qenë se është edhe prioritet turistik.
- Kanali vaditës gjithashtu duhet të pastrohet sepse shërben edhe për kullimin e tokave.
- Duhen vendosur në përdorim të Bashkisë pronat shtetërore.

**Z.Gzim Metalaj,** fshati Mushan shprehet po ashtu se:

- Rruga e shkollës krijon shumë problem për banorët.
- Edhe rruga e Mllojeve ka nevojë për ndërhyrje.
- Problematika me rrjetin e OSHEE-së ka në të gjithë Dajçi.
- Kanalet kulluese gjithashtu kanë nevojë të pastrohen.
- Nuk ka rrjet për ujin e pijshëm në fshatin Mushan.

**Kryeplaku,** fshati Samrisht i ri thotë se çdo vit bëhen takime të tilla por kërkësat e tyre nuk janë realizuar. Ai shton se:

- Ka nevojë që të bëhen investime në zonën e tij.
- Prioritet është rruga pranë qendrës shëndetësore.
- Uji i pijshëm në Samrisht ka rrjet të amortizuar dhe duhet të nderhyhet sa më parë.

**Banor,** fshati Rrushkull shprehet se ato kanë nevojë për:

- Infrastrukturë rrugore dhe ndriçim.
- Rrjeti i OSHEE-së është shumë problematik.
- Rruga e fshatit është akoma e pa ndërtuar.

**Z. Marash Marku,** fshati Suka Dajc thotë se:

- Mungon uji i pijshëm në fshat.
- Nuk kemi as vaditje as lera uji për bagëtitë.
- Nuk kemi qendër shëndetësore, dhe janë 140 shtëpi në zonë.
- Rruga e varrezave të fshatit është e amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje.
- Ka nevojë për ndriçim në rrugët e fshatit.

Edhe kryetari i fshatit Belaj shprehet se nuk ka patur asnjë investim në fshat.

**Znj. Albina Kulla,** drejtoreshë në shkollën e fshatit Dajç shprehet në lidhje me shkollën që drejton:

- Nxënësit kanë filluar shkollën pa u pastruar dhe sistemuar shkollat, pa u lyer ambjentet dhe pa u bëre asnjë punë në këto mjedise.
- Rruga e shkollës rreth 200 metra ka nevojë për ndërhyrje.
- Shkolla nuk ka mjedise të mjaftueshme, duhet të kete ambjente sportive sepse ka vite pa asnjë mirëmbajtje apo rikonstruksion.
- Është e nevojshme të bëhet ndarja e oborrit të shkollës nga qendra shëndetësore.
- Në kopshtin në Shirq ka problem me derën dhe strukturën.
- Kërkojmë që të spostohet kopshti i Shirqit në qendrën multifunksionale të Dajçit.
- Është e nevojshme që të hapen grupe të tjetra kopshti.
- Duhet të vendosen stola në oborret e shkollave sepse nuk ka asnjë.

**Kryetari i Njësisë Dajç,** shprehet se problem më i madh për ne është certifikimi i pronës. Kjo na krijon pengesa, pasi ka toka që nuk janë të ndara as me ligjin 7501.

- Hyrja për në fshatin Dajç që lidhet edhe me rrugën e Velipojës është shumë problematike dhe ka nevojë për trajtim teë saj për të rritur sigurinë.
- Në kopshtin e fëmijëve në Shirq, pas proçesit mësimor është bërë një aktivitet me një projekt.Është e rëndësishme për komunitetin që të vazhdohet sërisht ky shërbim në këtë zonë sepse është ndihmesë për gratë që punojnë dhe kanë nevojë të lënë fëmijët në këtë qendër.
- Ka gjithashtu nevoja të shumta për mbyllje të gropave dhe riparime të rrugëve në të gjithë njësinë.Duhen patjetër të inspektohen dhe identifikohen nevojat.

**Z.Bejleri** informon të pranishmit mbi projektet që janë në zbatim dhe ato të planifikuara për vitin tjetër në lidhje me kanalet kulluese e vaditëse.

Përsa i përket problematikës me OSHEE, shton ai, kemi bërë kërkesë te operatori për rehabilitim të këtyre linjave. Jemi në pritje që të zbatojnë këtë ndërhyrje për sistemim të rrjetit elektrik.

Kemi gjithashtu të parashikuar asfaltimet e rrugës së varrezave, rrugës pranë xhamisë në Belaj dhe rrugës në lagjen Rrushkull. Do jetë në prioritetin tonë edhe rruga e shkollës në fshatin Mushan.

**Doktori i Njësisë administrative Dajç** shprehet se janë 5 godina që ofrojnë shërbim shëndetësor që kanë nevojë urgjente për ndërhyrje në infrastrukturë sepse janë të amortizuara.

**Z.Shabani,** kërkon të dijë nëse ka Bashkia ndonjë plan për menaxhimin e ujrave të zeza, së paku në fshatrat që janë të grupuara? Ai shton se edhe rruga në kryqëzim të fshatit Mushan ka nevojë për ndriçim.

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se është në proçes studimi për ndërhyrje në disa fshatra për kanalizimet e ujrave të zeza.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Onid Bejleri** mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE**: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"

*Njësia Administrative Dajç*

*Datë:* **16.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | [illegible] | [illegible] | 0692310647 | | [signature] |
| 2) | ALBINË KULLA | SH "LUGË" AGRAJA | 0674060567 | [illegible]@yahoo.com | [signature] |
| 3 | Mark Simoni | Daja | | | [signature] |
| 4 | [illegible] | [illegible] | 0693473740 | | [signature] |
| 5. | [illegible] | [illegible] | 0652254276 | | [signature] |
| 6. | Alfred [illegible] | [illegible] | [illegible] | | [signature] |
| 7. | [illegible] | [illegible] | [illegible] | | [signature] |
| 8. | Arben [illegible] | | | | [signature] |
| 9. | BLEDAR OBLIKA | | 0685506420 | | [signature] |
| 10. | Alfred [illegible] | [illegible] | 0683303869 | | [signature] |
| 11. | [illegible] | Suka | 0652616408 | | [signature] |
| 12. | [illegible] Molla | Belaj | 0672633611 | | [signature] |
| 13 | Viktor [illegible] | [illegible] | 0692654791 | | [signature] |
| 14 | Marash [illegible] | Suka | 0692107447 | | [signature] |
| 15. | [illegible] | Rrushkull | 0674557034 | | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Denis Muza | Kusha | [illegible] | | |
| 17 | Valentin Bolayka | Dobrajat | 068 3098929 | | |
| 18 | HAMDI MLLOJA | MUSHANH | 067 45 19 097 | | |
| 19 | Allyon Selyce | B. Shkodre | 0672082858 | | |
| 20 | Ensi Kelmetlaj | | | | |
| 21 | Arben Pala | Shirq | 0692087661 | | |
| 22 | Anton Zadrima | Shirq | 0693161418 | | |
| 23 | Esat Hasani | DARRagjat | | | |
| 24 | Gjet Millaj | Samrish Vjeter | 0692385095 | | |
| 25. | Antonio Shkurtaj | SAmrish Vjeter | 0693433706 | | |
| 26 | MARK KOLDJI | [illegible] | 0673366180 | | |
| 27 | Majlinde Mandi | DAJC | 069286 1500 | majlindemandi@gmail.com | |
| 28 | Flaudora Lukaj | DAJC | 0673224166 | flaudoralukaj@gmail.com | |
| 29 | BESNIK HAXHIA | Q. SH. DAJC | 06925 16 104 | haxhiabesnik@yahoo.com | |
| 30 | Edita Shoshi | BASHKIA SHK | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Njësia administrative Gur i Zi.

**Data :** *19.09.2024* **Ora :** *13.00* **Vendi:** Pranë Njësisë administrative.

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 31, nga të cilat 3 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Kryetari i Këshillit Bashkiak **Z.Luli** hap takimin dhe shprehet se në këtë takim do diskutohet mbi problematikat që lidhen me funksionet e Bashkisë të përcaktuara në ligj. Ndër to ai veçon menaxhimin e mbetjeve, ndriçimi publik dhe infrastruktura rrugore, menaxhimi i objekteve arsimore, shëndetësore e sociale si dhe punët e ndryshme që duhen bërë në shërbimet bujqësore.

Gjithashtu ai thekson faktin se duhet kuptuar që flasim për buxhete vendore për të cilat jemi të varur nga të ardhurat që marrim nga njësitë administrative dhe qyteti prandaj është me shumë rëndësi edhe vjelja e ketyre të ardhurave. Do të fokusohemi tek nevojat emergjente për tu parashikuar për zbatim në vitin 2025 dhe për ato që kërkojnë angazhime me të medha financiare të cilat mund të planifikohen per 2026 – 2027.

**Kryetari i njësisë administrative** paraqet një përmbledhje të punëve të realizuara në njësinë e Gurit të Zi:

- Është kryer argjinatura në fshatin Juban.
- Ka përfunduar ndërhyrja në kanalin e Gajtanit.
- 50 % e kanaleve të dyta dhe të treta janë përfunduar.
- Është bërë vendosja e urave dhe tombinove në pikat më problematike për përmbytje.
- Frekuenca e pastrimit është shtuar në 3 herë në javë.
- Është hapur një kopësht fëmijësh pas kërkesës së banorëve të zonës.
- Jemi në fillim të punës për rrugën Spathar – Kuq.
- Gjithashtu po punohet në kanalin vaditës Juban.
- Në përroin e Pistallës është në proces fillimi i zbatimit të ndërhyrjes për mbrojtje.

Ai shton se problematikë mbetet:

- Një përrua në Gurin të Zi krijon probleme dhe përmbytje në kohë rreshjesh.
- Problem tjetër është mungesa e trotuareve.
- Nuk ka lulishte apo kënde lojrash për fshatrat.
- Gjitashtu kemi mungesë bashkëpunimit nga ana e drejtorive rajonale me njësinë administrative dhe me bashkinë, sidomos për mësuesit ( transporti i tyre ), me OSHEE-në etj.
- Kemi shumë banorë që aplikojnë për të marr me qera tokë në një pjesë prej 16 km breg liqenor në Rragam – Mazrrek - Liqeni i Vau Dejes (janë prona shtetërore të Bashkisë) duhet të shihet mundësia për ti dhënë këto toka me qera.
- Sa i përket shërbimit urban kërkojmë që të ketë një vendparkim për furgonët dhe autobuzat e Gurit të Zi sepse ndalesa është shumë larg.

**Zv/Kryetari Z.Rudin Beka** shprehet lidhur me vendparlimet duke thënë se jemi në proces të planifikimit dhe ndërtimit të parkut të autobuzeve, ku do të jetë i mundur parkimi i çdo mjeti.

**Z. Jaku,** banor fshati Juban shprehet rreth problematikave dhe nevojave të zonës:

- Kemi nevojë për ndërtimin e një trotuari në Juban, në dukje i parëndësishëm por është me shumë rëndësi për banorët sepse është pranë rrugës kryesore dhe përbën rrezikshmëri edhe për fëmijët që shkojnë në shkollë. Gjatësia e këtij aksi është rreth 1.2 km. Gjithashtu në këtë rrugë mungon edhe ndriçimi.
- Ujësjellësi vazhdon të jetë problem, nuk ka ujë të pijshëm në banesa. Ka vetëm nevojë për mirëmbajtje dhe riparime në rrjet.
- Rrugicat brenda fshatit kanë nevojë për riparim për t'i dhënë më shumë vlerë Jubanit sepse është zonë shumë e bukur dhe ka edhe vlera turistike.
- Vazhdojmë të kemi probleme të mëdha edhe me rrjetin elektrik.

**Banor,** fshati Vukatan thotë se:

- Kemi problem me AMTP dhe pronat në zonën e Vukatanës.
- Rrugët në Vukatanë janë të gjitha të pashtruara.
- Në Shpor e Mazrek janë restauru 10 shtëpi por nuk kemi asnjë cm rrugë.
- Mungojnë emërtimet e rrugëve.

**Z. Erjon Hasmegaj**, Imami i Xhamisë Ganjoll shprehet se:

- Gjanjolla është fshati me i fundëm në kufi me Vaun e Dejës me një ekonomi shumë të dobët.
- Varrezat në Ganjollë janë problem më vehtë pasi duhet të shihet mundësia për shtim hapësire/parcelash.
- Ganjola nuk ka ujësjellës. Jemi përpjekur me shpime dhe puse por duhet që Bashkia të ndërhyje për këtë çeshtje.
- Kemi pasur një aksident në zonë para disa ditësh dhe falenderojmë Bashkinë sepse ka nderhyrë me vendosjen e sinjalistikës sepse është një aks shumë i rrezikshëm.
- Zona pranë xhamisë ka nevojë për shtrim asfalti.
- Lidhur me menaxhimin e mbetjeve, kemi 2 kosha në të gjithë fshatin dhe kemi nevojë të shtohen të tjkrë pasi janë të pamjaftueshëm.
- Ganjolla nuk ka as kopësht, as çerdhe e as shkollë. Të gjithë fëmijët shkojnë në shkollat e Jubanit ose në Gur të Zi etj.
- Të shihet mundësia e vendosjes së dy kabinave për pritjen e autobusit në kohë reshjesh.
- Kemi nevojë edhe për një park rekreativ në Ganjolle, fushë sportive apo aktivitete për fshatin dhe banorët.
- Gjithashtu Ganjolla ka kalanë e saj por mungon sinjalistika, mungon rruga. Mund të shihet si mundësi për turizmin.
- Duke qënë se Ganjolla ka ekonomi të ulët, prandaj duhet që shtresat në nevojë të kësaj zone duhet te angazhohen në punësim në projektet që do zhvillohen në zonë.
- Ganjolla dhe Jubani janë zona me resurse të mëdha tokash që mund të kenë ullinj e të tjera produkte prandaj duhet të ketë një koordinim nga ana e Bashkisë përsa i përket tregtimit të këtyre produkteve dhe magazinimin e tyre.
- Gjithashtu edhe tek kisha e Rruzares ku është bërë asfalti mund të ishte sistemuar edhe pjesa e parkingut.

Kryetari i Këshillit bashkiak **Z. Luli** vlerëson shumë sugjerimet dhe informon në lidhje me pagesat e zonës, kemi një realizim prej 22 % në të ardhura dhe është me shumë rëndësi që të kemi edhe pagesa të tarifave dhe taksave për të mundësuar shërbim më të mirë.

**Banor**, fshati Vukatanë shprehet se:

- Ka nevojë të kryhet pastrimi i rrugës Vukatanë - Shkodër nga ferrat në të dyja anët e rrugës sepse është shumë e rrezikshme për fushëpamjen.
- NË Vukatanë ka nevojë urgjene për vendosen Bumesh sepse është rrugë shumë e rrezikshme për shkollën dhe banorët e zonës.

**Z.Jakup Mani,** fshati Vukatanë shpreh shqetësimin e tij duke thënë se ka bërë aplikimin për tapinë e shtëpisë dhe akoma nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ai shton se ka kryer të gjitha pagesat që kanë ardhur nga Bashkia dhe përsëri nuk është pajisur me dokumentat e shtëpisë.

**Z. Vasil Lazri,** operator i shërbimit të transportit për Gurin e Zi – Shkodër shprehet se:

- Kemi problem për vend qëndrimin në Shkodër. Stacioni është në afërsi të shkollës Ndoc Mazi por është shumë larg nga qendra e qytetit dhe është zonë pa sinjalistikë

dhe e rrezikshmë. Kërkojmë të shihet mundësia e krijimit të një stacioni të përkohëshëm deri në ndërtimin e terminalit.

- Linjat e brendshme të qytetit mungojnë prandaj duhet të ketë një linjë provizore nga stacioni i trenit deri në qendër Shkodër.
- Duhet të ketë kontroll edhe për furgonët që futen jashtë ligjit deri në qendër të qytetit.

**Znj. Donika,** fshati Guri i Zi thotë se:

- Kemi nevojë të hapet një rrugë pranë liqenit.
- Gjithashtu edhe rrugët e fshatit duhen minimalisht të shtrohen çakull.

**Banor,** fshati Rragam shprehet se asnjëra nga kërkesat që kemi shprehur vitin e kaluar nuk është marr parasysh, gjithashtu ai shton se:

- Problemi kryesor është ura e Rragamit.
- Ujësjellësi ka problem vazhdimisht dhe punësimin në zonë.

Ai vlerëson faktin se në fshat po punohet për ndriçimin publik dhe mesa flitet edhe për urën Bashkia Shkodër do fillojë punën.

**Z. Fred Gjuraj,** fshati Juban thotë se:

- Rrjeti i energjisë elektrike është krejtësisht i amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje urgjente.
- Rrugët e brendshme të fshatit janë në gjendje shumë të keqe.
- Edhe rruga kryesore ka nevojë minimalisht të zgjerohet sepse është shumë e ngushtë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Gur i Zi***

***Datë:* 19.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pjetër Marku | Shelqi | 0682134464 | | [signature] |
| 2 | Pjetër Ndreu | Juban | 068545971n | | [signature] |
| 3 | Paulin Zefi | Juban | 0683752656 | | [signature] |
| 4 | Ferdinand Zefi | Juban | 0671780430 | | [signature] |
| 5 | Arben Simoni | KRENCË | 0684145922 | | [signature] |
| 6 | Jakup Mani | [illegible] | 0692454482 | | [signature] |
| 7 | Bahri Osmani | Vukatan | 0675582326 | | [signature] |
| 8 | Cufe Aziz | Vukatane | 0682787749 | | [signature] |
| 9 | Artur Meti | Kuç | 0692932758 | | [signature] |
| 10 | ILIR HAXHIJA | GURI ZI | 0672741490 | | [signature] |
| 11 | ZAIM HAXHIJA | GURI ZI | | | [signature] |
| 12 | Vlash [illegible] | Drenë | | | [signature] |
| 13 | [illegible] Markaj | Rragam | 0682322190 | | [signature] |
| 14 | Zef Kole | Gojan | 0676188123 | | [signature] |
| 15 | Gjergj Kolia | Juban | 0682029719 | | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Mirash Cobaj | Shpor | 0683570087 | | [signature] |
| 17 | Denis Loffja | Kuq | 0697753550 | denis96loffja@gmail.com | [signature] |
| 18 | KLODIAN SIMONI | GURI-ZI | 0697784798 | | [signature] |
| 19 | Frane Toka | Juban | 0682166841 | | [signature] |
| 20 | Roland Zhuka | Guri i Zi | 0692022800 | | [signature] |
| 21 | Sander Lozu | M.. Gon | 0672794451 | | [signature] |
| 22 | Dobrush Morda | Juban | 0676699052 | | [signature] |
| 23 | Eduart Lazri | Juban | 0693211665 | | [signature] |
| 24 | Berhan Teli | Vukatan | 0675696225 | | [signature] |
| 25 | Arjan Thaliki | RRAGAM | 0672944767 | | [signature] |
| 26 | Samir Guri | Vukatanë | 0692400039 | | [signature] |
| 27 | Donika Voza | 0695818249 | | | [signature] |
| 28 | Katrina Voza | | | | [signature] |
| 29 | Shyqyri Holi | | 0672544492 | | [signature] |
| 30 | RAFFAELE GAGLIARDI | GUR i ZI | 0692186902 | | [signature] |
| 31 | Erion Hasmegaj | Ganjollë | 0673802445 | | [signature] |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Rajoni nr.1.

**Data :** *20.09.2024* **Ora :** *13.00* **Vendi:** Salla e Këshillit Bashkiak

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 17, nga të cilat 6 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr fillimisht Z.Besmir Nabolli, administrator i Rajonit nr.1 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.1 të qytetit. Ndër të tjera ai përmend:

- Rikonstruksion i degëzimit të rrugës "Myzafer Pipa" dhe sheshit pranë degëzimit.
- Rikonstruksion i Rr. "Ethem Kazazi".
- Rikualifikimi i segmentit të rrugës "Labeania", para shkollës "Ruzhdi Daca".
- Rikostruksion Rr. "Krajej"
- Rikostruksion Rr. "Jul Variboba"
- Riparimi i Rr. "Gjylbegej"
- Rikonstruksion i Rr. "Lamijej"

- Riveshje me asfalt Bulevardi "Bujar Bishanaku" dhe ndriçim led.
- Ndriçimi led në rrugën Bulevardi "Zogu i I" dhe në rrugën "Faik Konica".
- Rehabilitim i molos në Pazar.
- Sistemi me semafore në Parrucë.
- Korsi për biçikleta unaza perëndimore.
- Rehabilitim i rrugëve "Et'hem Osmani" dhe "Faik Konica"
- Veshje me kapot dhe grafiato pallateve në Bulevardin "Zogu I"
- Rikualifikimi urban tek blloku i pallateve rr. "Isuf Sokoli" është në proces.

**Ndërhyrje që do bëhen në vazhdim në Lgj. Nr 1:**

- Rikualifikim urban te blloku i pallateve tek ish të përndjekurit.
- Rikonstruksion total i shkollës "Ndre Mjeda"
- Rikonstruksion total i shkollës "Ismail Qemali"
- Projekti për hyrjen e qytetit.
- Rikualifikim urban në Zdralej.

Gjithashtu edhe **Zv/Kryetari Z.Bejleri** thotë që për rajonin nr.1 parashikohet edhe një paketë tjetër investimesh në fasadat e pallateve, ku përfshihen një pjesë e konsiderueshme e pallateve të kësaj zone. Po ashtu parashikohen edhe një sërë asfaltime rrugësh, të cilat do fillojnë të realizohen muajt e parë të vitit të ardhshëm në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Do vijojmë edhe me ndriçimin publik dhe me investimin më të rëndësishëm që prek edhe këtë rajon, që është fillimi i rrugës Shirokë – Zogaj.

**Banor,** lagjia "Ahmet Haxhia". Ndocaj shprehet se njëra nga rrugët nga kryqëzimi për në Livadhe, konkretisht rruga "Hoxhë Kadrija" është e vetmja rrugë që ka problem me asfaltimin dhe me kanalizimet. Nuk është vënë dorë asnjëherë. Ka nevojë urgjente për ndërhyrje.

**Z.Luli** sqaron se për rrugën në fjalë është depozituar pranë Bashkisë Shkodër edhe një kërkesë nga një grup Këshilltarësh, prandaj do merret patjetër në konsideratë përfshirja e saj në buxhet.

**Znj.Bora Miruku**, banore Lagjia "Ahmet Haxhia" thotë se:

- Njëra nga rrugicat e rr.Kasem Taipi ka nevojë për ndërhyrje në asfaltim, kanalizime dhe për ndriçim , pasi në kohë shirash krijon shumë problem për banorët. Vetë banorët para disa vitesh kanë shtruar çakull por tani që çdo rrugicë përreth është shtruar, kjo nuk është as imazh i bukur për qytetin.
- Gjithashtu duhet që të shihet mundësia e një ambjenti sportiv apo rekreativ për fëmijët e zonës duke patur parasysh edhe shfrytëzimin e ambjenteve të shkollës "Salo Halili".

**Z.Frederik Shestani**, banor i Shirokës përgëzon stafin e Bashkisë Shkodër për punën e bërë në Shirokë por shprehet se:

- Duhet që plazhi t'i kthehet për shfrytëzim qytetarëve të Shkodrës.

- Duhet gjithashtu të ndërhyhet në shkarkimin e ujrave në rrugët e Shirokës pasi në kohë rreshjesh ato bllokohen dhe bëhen të pakalueshme.

**Z.Andi Halluni**, përfaqësues i bizneseve në zonën e Shirokës shprehet se:

- Kemi nevojë që të ndërhyhet në rrugën e Shestanëve. Kjo rrugë është shtruar privatisht para disa vitesh por tani duhet të ndërhyhet nga Bashkia për tu zgjeruar dhe asfaltuar,pasi bëhet pengesë në mbarëvajtjen e bizneseve aty.
- Gjithashtu kemi nevojë për prezencë të shtuar të policisë Bashkiake pasi shpesh herë krijohen problem nga parkimet e gabuara.

Fjalën e merr **Znj.Pode,** anëtare e Këshillit Bashkiak e cila shpreh disa shqetësime në lidhje me Shirokën:

- Duhet medeomos të ketë banjo publike në Shirokë, sidomos në sezonin veror.
- Duhet të ketë më shumë prezencë të Policisë bashkiake për parkingjet sepse shpesh herë qytetarët penalizohen pa të drejtë.
- Po ashtu duhet të shtohet frekuenca për pastrimin e mbetjeve.
- Qendra shëndetësore e Shirokës ka nevojë për ndërhyrje/rehabilitim pasi është e vetmja qendër që mbulon të gjithë zonën aty.

**Z.Luli** në lidhje me pastrimin pyet Z.Altin Shabaj, specialist pranë drejtorisë së shërbimeve publike, nëse ka ndryshuar frekuenca apo ka shtim të numrit të kazanave në Shirokë?

Përgjigjet **Z.Shabaj** dukle thënë se kemi shtuar numrin e kazanëve dhe tërheqja e mbetjeve bëhet çdo ditë. Gjatë verës, sipas nevojës është kryer edhe dy herë në ditë.

**Z.Anamali**, anëtar i Këshillit Bashkiak, kërkon të dijë lidhur me zërat e shpenzimeve të PBA-së për 2025-2027:

- Se sa është planifikuar për lagjen nr.1?
- Çfarë investimesh kapitale do ketë për këtë zonë të qytetit?
- Sa metër linear rrugë dhe trotuare do bëhen për lagjen nr.1?

**Z.Luli** sqaron se përgjigjet mund t'i gjeni në dokumentin e parë të PBA-së, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti** -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Lagjja nr.1***

*Datë:* **20.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Irma Koplliku | Lagja 1 | 0695764166 | irma_koplliku@yahoo.com | |
| 2 | Eliona Shkreli | Lagja 1 | 0674674716 | | |
| 3 | Irena Shkoza | Rr. M. Beqiraj | 0684021687 | irenashestani@gmail.com | |
| 4. | Voljeta Bajraktari | Lagjia 1 | 0672784493 | voljeta_polm@yahoo.com | |
| 5 | Bora Miraku | Lagja 1 | 0672123575 | mirakubora@yahoo.com | |
| 6 | Eridi Erhocaj | Lagjia 1 | 0695656525 | | |
| 7 | FEDERIK SHESTANI | SHIROKË | 067 455 1141 | | |
| 8 | Malio Daija | L. Ahmet Haxhia | 0693723463 | | |
| 9 | Vladimir Gjergji | L. Q. Stafa | 0682197170 | | |
| 10 | Audi Hoxllumi | Shiroke | 0674035559 | audhollumi@gmail.com | |
| 11 | ANDI KADIJA | INSPEKTOR | 0698920444 | | |
| 12 | FATDRIT ASLLANI | INSPEKTOR | 067 232 0555 | | |
| 13 | Mazim Hasani | | 0692166436 | | |
| 14 | Rezarta Pepe | Keshilltare | 0692437830 | | |
| 15. | Florent Ahmeti | Rajoni | | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16. | Albi Çuloj | Lagje 1 | 0697717977 | albiculoj@yahoo.com | [signature] |
| 17. | Fetion Vegshari | Lagjja 1 | 06[illegible]7333123 | | [signature] |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik** : Rajoni nr.2.

**Data** : *23.09.2024* **Ora** : *13.00* **Vendi:** Salla e Këshillit bashkiak.

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 30, nga të cilat 7 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Kryetari i Këshillit **Z.Luli** hap takimin me banorët e lagjes nr. 2. Ai sqaron se takimi është informuar sipas ligjit në faqen zyrtaretë Bashkisë Shkodër si dhe me komunikime përmes administratorëve të zonës. Deri me tani janë kryer një sërë punësh sa i përket infrastrukturës urbane. Baza e këtij buxheti janë taksat dhe tarifat lokale përveç financimeve të ardhura nga qeveria qëndrore. Krahas prioriteteve të identifikuara nga administrata kërkojmë që të kemi edhe nga ana e banorëve propozime sa i përket përmirësimeve në:

1. Transport dhe menaxhim mbetjesh
2. Gjelbërim dhe ndriçim
3. Infrastrukturë rrugore
4. Mirëmbajtje e objekteve arsimore dhe shëndetësore

Si dhe çdo funksion dhe detyrim që i takon Bashkisë. Presim ëe marrim nga ju propozime rreth ndërhyrjeve afatmesme por edhe planeve afatgjata që mund të behen për zonën nr. 2 të qytetit gjithmonë duke mbajtur parasysh buxhetin dhe mundësinë e fondeve të Bashkisë.

Takimi i sotëm shton **Z.Luli** do koordinohet me **znj. Teuta Qyteza** dhe administratorin e zonës **Z.Rubin Borshi**, i cili do te bën edhe një prezantim të shkurtër të punëve që janë bërë deri më tani në lagjen nr. 2 dhe të atyre që janë të planifikuara për të ardhmen.

**Z. Rubin Borshi** prezanton punët e realizuara në lagjen nr. 2 duke theksuar rëndësinë e kërkesave të bëra nga qytetarët pas ardhjes në detyrë të Z. Beci. Ndër të tjera ai përmend:

- Përmirësim në infrastrukturë dhe në shërbimet në terren duke përmirësuar kështu kushtet e jetesës .
- Janë realizuar rrugët: Bujar Bishanaku, Rruga e Tafilicëve, Ali Pashë Gucija, Adem Kastrati, Hasan Muhamet Halluni etj.
- Kemi ndërhyrë në rikonstruksionin dhe veshjen termike tek blloku i pallateve në rrugën Europa.
- Është investimet në ndriçimin publik me LED në bulevardin Bujar Bishanaku dhe sheshin Demokracia.
- Kemi rritje të efiçencës së mirëmbajtjes së mjedisit ku është përmirsuar shërbimi i pastrimit me shtim të kontenierëve.
- Punime me gjelbërimin publik në rrugën Europa, krasitje pemesh duke i dhënë një pamje publike me të sigurtë dhe të bukur.

Gjithashtu shton **Z.Borshi** kemi një sërë punësh në proces dhe të planifikuara për në vazhdimësi.

**Zv/Kryetarja Znj. Teuta Qyteza** shprehet se me investimet e bëra gjatë 9 muajve kemi një rritje të besueshmërisë tek Bashkia dhe presim që të realizojmë edhe kërkesa të tjera.

Fjalën e merr **Z.Fatmir Dekovi,** banor Rus, rruga Përparimi i cili shprehet se

- Prioritet për ndërhyrje duhet të jetë 100 metra rrugë tek Merkata pasi ka vite që nuk është ndërhyrë te kjo rrugicë.
- Kemi edhe probleme me shtyllat e OSHEE-së të cilat janë krhtyer në rrezik tashmë nga amortizimi.
- Duhet ketë më tepër punësim për të rinjtë e zonës ku banon.
- Është e nevojshme të pastrohet edhe rruga "Lëvizja e Postribës" nga barishtet.

**Z. Eukled Kinka,** banor po në ketë lagje shton se rrugica që u përmend përveç asfaltit ka nevojë edhe për kanalizimet e duhura.

**Z.Selim** , banor pranë shkollës " Xheladin Fishta" shprehet se:

- Pallatet e vjetra parafabrikate janë të demtuara dhe krijojnë rrezik për banorët.
- Kanalet e ujrave të bardha janë të dëmtuara.
- Qendra shëndetësore e lagjes nr. 2 është shumë e vogël dhe pa asnjë kusht.
- Kemi një rrugicë prej 55 metrash e cila është nën nivelin e rrugës kryesore dhe ka çdo herë përmbytje nga rreshjet.
- Shkolla "Xheladin Fishta" ka një fushë sportive, e cila nuk ka me asnjë kusht.

- Në rrugën nga qendra e Rusit për në Kiras makinat e druve janë problem për kalimtarët. Duhet ndërhyrja nga Policia Bashkiake.
- Kërkojmë që të ndryshohet edhe emiri i rrugës së Kumbullave (në Dërgut).

**Z.Rubin Borshi** shprehet në lidhje me makinat e drurëve duke thënë se shpesh kemi marrë masa me policinë bashkiake dhe do të vijojmë të monitorojmë situatën.

**Z.Xhavit Halluni**, banor rruga Mehmet Xhelil Fishta thotë se :

- Kemi rrugë akoma të pashtruara dhe pa ndrçim.
- Rruga e "Bisht Iqinisë", nuk ka kanalizime të ujrave të bardha e të zeza.

**Z. Engjell Radohina,** banor rruga Qemal Dracini shprehet se:

- Për rreth 20 metra linear, nuk mund të kalojnë as karrocat e paraplegjikëve. Ai shton se merr përsipër ta shtrojë privatisht rrugën por ka problem me pronarët dhe prandaj nuk është ndërhyrë. Duhet parë situate juridikisht.
- Gjithashtu kemi edhe një shtyllë në mes të rrugës që krijon problem për ndërhyrje.

**Z. Hysen Shakshaj** flet po ashtu lidhur me rrugën e "Bisht Iqinisë", duke thënë se ka nevojë për asfaltim dhe kanalizime.k

- Shkolla "Azem Hajdari" është e vetmja shkollë ku oborri i shkollës përmbytet sepse nuk ka kanalizime. Duhet ndërhyrë me patjetër.

**Drejtori i shkollës "Skenderbej"** shprehet se urgjente për shkollën është rikonstruksioni i tualeteve dhe palestrës.

**Z. Bajram Shkëmbi,** banor rruga "Besa Shqiptare" shprehet se:

- Duhet të bëhen kanalizimet e ujrave të bardha e të zeza në këtë rrugë.
- Ka nevojë për rrjet ndriçimi.
- Pranë banesave kalon rrjeti i tensionit të lartë, i cili është shumë i rrezikshëm prandaj duhet të gjindet një sistemim.

Banor, lagjia "Naim Gjylbegu" thotë se pallatet janë të pasovatuara dhe goxha të amortizuara prandaj duhet parë mundësia për ndërhyrje.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin:

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Lagjia nr.2***

*Datë:* **23.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Eliona Shkreli | – | 0674674716 | | [signature] |
| 2 | Hendrik Llukaj | | 0682744110 | | [signature] |
| 3 | RIDVAN LLAZANI | | 0692105483 | | [signature] |
| 4 | Bekim Kraja | | 0672127799 | | [signature] |
| 5 | Selim [illegible] | | 0672122830 | | [signature] |
| 6 | FATMIR Bu[illegible] | | 0692287187 | | [signature] |
| 7 | Luciane [illegible] | | 0682265960 | | [signature] |
| 8 | Orjeta Sejdija | | 0676666102 | | [signature] |
| 9 | Salvador Abdaj | | 0693208467 | | [signature] |
| 10 | ALMA MUJAXHI | Nr.2 | 0694774433 | alma.mujaxhi@gmail.com | [signature] |
| 11 | Eukli[illegible] Kola | | 0693550000 | | [signature] |
| 12 | Nexhmije Abdulla | | | | [signature] |
| 13 | Altin Shoshi | | | altinshoshi@gmail.com | [signature] |
| 14 | Albi Culaj | | 0697717877 | albi.culaj@yahoo.com | [signature] |
| 15 | Omar Myftiu | | 0697808081 | | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Kliud Elbasani | Lagjja Kr2 | 0685285525 | | |
| 17 | Edite Shoshi | BASHkia sht | | | |
| 18 | Jer3 [illegible] | Dritlev Shkoder | 0686555655 | | |
| 19 | Bejkan Vukaj | L. 2 | 0682978144 | | |
| 20 | [illegible] | Lagj. 8 | 0683655558 | | |
| 21 | Juf Alija | L Partizani N0 2 | 0682216857 | | |
| 22 | Kol Gjoni | Vojkuqh | | | |
| 23 | Myhedin Ismaili | Vojo Kush | | | |
| 24 | [illegible] | | 068 2041741 | | |
| 25 | XHAVIT HALLUNA | KIRAS | 0686045527 | | |
| 26 | Hyen Fshaui | Kiras | 0673421843 | | |
| 27 | Gëzim Vasaj | Kiras | 0672888113 | | |
| 28 | Vjezim Synoj | Kiras | 0672102080 | | |
| 29 | Bledian Nika | K. Bashkiak | | | |
| 30 | Rezarta Pade | Keshilltore | 0692437830 | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Rajoni nr.3.

**Data :** *24.09.2024* **Ora :** *13.00* **Vendi:** Salla e Këshillit bashkiak.

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 34, nga të cilat 9 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr fillimisht **Z. Anton Deda,** administrator i Rajonit nr.3 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.3 të qytetit. Ndër të tjera ai përmend:

- Riveshje rruga Kardinal Mikel Koliqi
- Mbyllja e të gjitha gropave të Lagjes nga NShPP
- Ndriçimi i ri në rrugën Gjuhadol, Marin Biçikemi, Kolë Heqimi.
- Buxhetuar 3 kaldaja (Branko Kadia, Mati Logoreci dhe Pashko Vasa)
- Në investim është fusha sportive e shkollës së muzikës "Prenk Jakova"

**Në vazhdimësi po punohet në:**

- Riveshje tek zona e Dollarit.
- Shtrim i disa shesheve të pallateve (Rruga Lin Delia, Hoti, Bashkimi, Marin Bicikemi)
- Buxhetuar sheshi i pallateve në rrugën Marin Bicikemi dhe rruga Ernest Bushati.
- Ndriçim i disa segmenteve të rrugicave të mbetura në kohë pa ndriçues.
- Ndriçimi i ri në rrugën Lin Delia dhe sheshit Dom Simon Jubani.
- Rikonstruksioni total i Tregut të Rusit, ku pasohet me investimin e godinës brenda tregut ku tregtohet mishi.

Fjalën e merr **Zv/Kryetari Bejleri** i cili shton se përveç investimeve që përmendi administrator parashikohen të kryhen edhe shtrime të tjera rrugësh me asphalt, sidomos prioritet do jetë bulevardi kryesor nga ish 5 Heronjt deri tek rrethrrotullimi I ish-Degës. Gjithashtu një paketë tjetër investimesh do jetë në fasadat e pallateve, veshje e tyre me kapotë, një pjesë e të cilave janë në Lagjen nr.3. Po ashtu do bëhet edhe rivitalizimi i të gjithë oborreve të shkollave të këtij rajoni.

**Banor, lagjia nr.3** merr fjalën, ku fillimisht përgëzon për punët e kryera. Ai shton:

- Rruga tek ndërmarrja "Rruga. Ura", tek "Hardhiat e egra" është kryer asfastimi por mungon ndriçimi, është rrugë kryesore që lidh 5 rrugica të zonës.
- Kemi gjithashtu edhe një rrugë , në të cilën nuk është vënë dore prej vitesh, ka nevojë për asfaltim , ndriçim etj sepse është e pakalueshme.
- Kërkojmë vëmendje të shtuar edhe për sinjalistikën rrugore, pasi shpesh herë kemi patur incidente.
- Në zonën në fjalë kemi 4 fabrika me numër të madh punëtorësh por rrugët aty janë krejtësisht të amortizuara dhe punëtorët nuk kanë ku të kalojnë.
- Mungon rrjeti i ujësjellësit. Banorët të vetmen zgjidhje kanë shpimet.

**Z. Martini** , banor tek zona e ish-Gropat e gëlqeres shprehet se aty banojnë prej viteve '90 një komunitet i ardhur nga zonat rurale. Ato kërkojnë që të kenë si pjesa tjetër e qytetit kushtet minimale të jetesës, të ndërhyhet në asfaltim, kanalime dhe ndriçim.

**Z.Çanga**, banor i lagjes "Qemal Stafa" ngreh një shqetësim lidhur me rrugën pas ish-Mapos së vjetër. Ai thotë se rruga është plot gropa dhe e pakalueshme prandaj duhet ndërhyrë pasi me ndryshimet në senset e qarkullimit rrugor në rrugën kryesore Parrucë është rritur fluksi i makinave dhe duhet me patjetër të riasfaltohet.

Sqaron këtu **Z.Bejleri** duke thënë se jemi në dijeni të situatës për rrugën në fjalë, por kjo është problematikë e rajonit 4.

**Z. Vilson Peshkaj,** banor i lagjes nr.3, Rr. Filip Parruca ( ish Fermentimi) shprehet se:

- Nga rruga e ashtëquajtur rr."Kasnecëve" deri në Fermentim janë vetëm dy rrugica të paasfaltuara. Janë kryer kanalizimet e duhura por mungon asfaltimi.
- Problem tjetër për këtë zonë vazhdon të jetë uji i pijshëm.
- Duhet të rishihet mundësisht edhe frekuenca e transportit publik, pasi shkollat janë larg për nxënësit.

**Banor,** rruga e " Badrave" thotë se:

- Zona ka problem me fluksin e makinave aty, duke mos patur vend për parking për vetë banorët.
- Kazanëve të mbeturinave i duhet gjetur një zgjidhje pasi vendi ku janë caktuar sjell shumë probleme për banorët e rrugës.
- Telat e energjisë elektrike dhe internetit janë imazh i shëmtuar, duhet bërë një sistemim i tyre.
- Tjetër problem është edhe ndriçimi dhe zhurma nga muzika e lartë që bëjnë bizneset.

**Znj. Arta Arsi**, banore në " Mehallen e Çakajve" merr fjalën dhe thotë se duhet të merret në konsideratë ndërhyrja në shtrimin e sheshit në lagjen e tyre. Ajo shton se tek ish-Befotrofi një qytetar ka bllokuar sheshin duke e kthyer në minifermë private, gjë kjo që po shqetëson komunitetin, prandaj duhet ndërhyrja e Policisë Bashkiake. Për më tepër në lagjen Rus nuk ka as kënd lojrash për fëmijë as ambjente të gjelbëruara për të moshuarit etj.

**Drejtoresha e shkollës "Pashko Vasa",** shpreh shqetësimet e shkollës që drejton:

- Hasim probleme me rregjistrimin e nxënësve të Komunitetit Rom, pasi nuk janë të rregjistruar në gjendjen civile.
- Parkimi i gabuar tek dera e shkollës sidomos në oraret e fillimit dhe mbarimit të shkollës, duhet gjetur një zgjidhje për këtë.
- Po ashtu kemi një familje që ka dalje në oborrin e shkollës, dhe nuk është aspak normale prandaj duhet të verifikohet situata dhe të merren masa.
- Kemi nevojë gjithashtu për riparime të vogla të shkollës, si p.sh: Lyerje, sistemimi i oborrit, palestra, dezifektim, dhe ndërhyrje në banjot e shkollës.

**Z.Martin,** banor në rrugën "Karl Gega" shprehet se zonën në fjalë nuk është bërë prej vitesh asnjë investim, nuk kemi as kanalizime të ujrave të bardha, as të zeza. Behet fjalë për një rrugë rreth 300m rrugë. Rruga "Pjetër Budi" është shtruar privatisht nga një biznes aty. Edhe tek hyrja e spitalit rruga është nën nivel dhe kur ka shira, rruga mbushet me ujë.

**Z.Kol Vlataj**, banor i lagjes Skenderbeg:

- Tek rruga "Pjeshka" , afër ish- konviktit të shkollës së rezervave , ujrat e zeza të 20 banesave aty, derdhen në bodrumin e pallatit duke rrezikuar përhapje sëmundjesh si dhe rrezikon strukturën e vetë pallatit, pasi është goxha i amortizuar.
- Zona në fjalë nuk ka ndriçim, prandaj duhet parë me përparësi.

**Z.Jozef Çoba,** banor i lagjes "Gjuhadol" shpreh shqetësimin e tij lidhur me pistonat për kalimin e makinave në atë rrugë. Ulje-ngritjet e pistonave duhet të komandohen me rregull, pasi banorët kanë nevoja. Kërkojmë ta kemi pultin e tyre edhe ne si banorë.

**Z. Nikolin Shqau**, banor i rrugës "Kardinal Mikel Koliçi" thotë se bizneset në këtë zonë zënë pa të drejtë hapësirat publike, për parkingje.

**Z.Paulo Kaceri**, banor tek parafabrikatet në lagjen "Skenderbeg", shprehet se akoma nuk është bërë asnjë ndërhyrje në oborrin e shkollës Branko Kadia. Si prind i 3 fëmijëve në atë shkollë kërkojmë ndërhyrje, pasi oborri është i pakalueshëm. Duhet bërë kanalizimet e ujrave të bardha e të zeza.

- Është ngushtuar rruga për korsitë e biçikletave ( shkolla Pyjore-Spitali), për tu parkuar makinat në dy krahët vetëm për 2-3 biznese aty.
- Rruga Prek Cali në afërsi të spitalit është problem se është e pashtruar dhe e ngarkuar nga parkingu i makinave.

Fatkeqësisht për lagjen në fjalë nuk është vënë në dorë prej vitesh.

**Z.Ervin Gjini**, banor i lagjes nr.3, rruga "Kokaj" shprehet se:

- Si zonë historike e qytetit duhet të ketë vëmendje të shtuar, sidomos përsa i përket shërbimit të pastrimit.
- Tjetër problem në lagjen tonë është edhe një banesë e braktisur, e cila është kthyer në vend depozitim mbeturinash. Shqetësim i madh për komunitetin.
- Po ashtu edhe bllokimi i rrugës nga pistonat bëhet në orare të pa koordinuara mirë.
- Edhe investimi në ndriçimin e rrugës tonë është i pa studiuar mirë, pasi bllokon pamjen e fasadave dhe stonon me pamjen e krejt asaj zone muzeale.

**Znj.Vjollca Petani,** anëtare e Këshillit bashkiak ndan të njëjtin shqetësim me disa nga banorët e lagjes nr.3, lidhur me trafikun e rënduar në atë zonë. Ajo shton se prej fluksit të rënduar shpesh herë ndodhin edhe incidente me banorët, Prandaj duhet të merren masa për tu gjetur një zgjidhje për situatën.

**Znj.Uarda Gjekaj,** anëtare e Këshillit Bashkiak merr fjalën dhe thotë se ajo kërkon që në buxhetin e ardhshëm të përfshihet rruga "At Shtjefën Gjegjovi", përsa i përket infrastrukturës, ndriçimit dhe sinjalistikës. Ajo shton se është një rrugë e ngushtë, me një kalim edhe me probleme nga parkimet vend e pa vend. Kërsesë kjo e përsëritur nga ana e saj.

**Znj.Rezartë Pode,** anëtare e Këshillit bashkiak ngreh një shqetësim lidhur me rrugën e Gjuhadolit, përsa i përket zhurmës që krijohet nga lokalet aty.
Tjetër shqetësim janë edhe mbetjet që lënë pas tregtarët e peshkut, pasi kazanat e mbetjeve kundërmojnë prej tyre. Duhet marr masa për menaxhimin e tyre.
Po ashtu edhe shërbimi i pastrimit duhet të kryhet saktë pasi vetëm boshatisen kazanët dhe nuk bëhet pastrimi i vendit përreth.

**Znj.Vjollca Jahja,** banore e lagjes nr.3 shprehet se shkolla e Muzikës nuk ka ngrohje, gjë kjo që duhet të jetë ndër prioritetet e buxhetit të ardhshëm.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Lagjja nr.3***

*Datë:* **24.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bepim Mi.ku- | SHKODER | 0672125390 | | |
| 2. | Angjelina Shllaku | Lagja 3 | 0686640055 | angjelina_shllaku@yahoo.it | |
| 3 | Eugj Gjini | Lagja 3 | 0694083251 | eurogjini@yahoo.it | |
| 4. | Valjeta Bajraktari | Keshilltare. | 0672784493 | valjeta.galeli@yahoo.it | |
| 5 | Eltona Shkreli | Keshilltare | 0674674716 | | |
| 6. | Violeta Rakaj | Keshilltare. | 0683924827 | | |
| 7. | Rezarta Dode | Keshilltare | 0692437830 | | |
| 8. | Ervis. Vezi | Lagja 3 | 0695153331 | [illegible]@hotmail.com | |
| 9. | Mendrit Petroni | Lagja 3 | 0697724235 | mendritpetroni50@gmail.com | |
| 10. | Norbert Toma | Lagjia 3 | 0676868008. | norberttoma@gmail.com | |
| 11. | Jozef Coba | Rajoni Nr.3 | 0674428090 | jozefcoba@gmail.com | |
| 12. | Paulin Kacinari | Rajoni Nr3 | 0676316609 | paulin.kacinari@gmail.com | |
| 13. | Viktor Pesdukaj | Rajoni Nr 3 | 0695757243 | viktor.pesdukaj@gmail.com | |
| 14. | Nikolin Mumaj | | 0673512762 | | |
| 15 | Ruli Damgo | Z Stafa | 0696105748 | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Nikolle Xhaferi | Fahri Ramadani | 0695469262 | | |
| 17 | Aleksander Dodoni | Dout Borici | 0694179016. | | |
| 18. | Nikolin Martin Shyqde | Vaso Shomo | 0694008090 | | |
| 19. | Rion Artyrene | [illegible] Xhuteli | 067 440 1063 | | |
| 20 | VIO LLESHI | Tom Kola | 0656981283 | | |
| 21 | ARTA ARSI | L. Fahri Ramadani | 0692992478 | | |
| 22 | Violla Jahaj | L. 2 | 0693123957 | | |
| 23 | PAL KERRECI | L 3 | 0689601850 | | |
| 24 | Kole Hardoj | L 3 | 0682424704 | | |
| 25 | Antoni Lushaj | L 3 | 0685802932 | | |
| 26 | GESK NDOU | L 3 | 0695387777 | | |
| 27 | Valtajn Gjeçaj | L 2 | 0682972754. | | |
| 28 | Dorathe Martini | Skenderbeg | 0683372705 | | |
| 29 | Joliel Romi | Skenderbeg | 0676948141 | | |
| 30 | ARDIANA LEPURI | Drejtore "Pashko Vasa" | 0676983281 | | |
| 31 | Marlin Alia | L. 3 | 0684034001 | | |
| 32 | Xoualin Shkjmi | L 3 Haq | 0692033958 | | |
| 33 | Martin Shqau | Vasil Shanto | 0683749432 | | |
| 34 | Fran Pumi | Skenderbeg | 0684001086 | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

# PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

## PËR

## "DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".

**Konsultim publik** : Rajoni nr.4.

**Data** : 25.09.2024 **Ora** : 13.00 **Vendi:** Salla e Këshillit bashkiak.

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 59, nga të cilat 16 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për drafi projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës** : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr fillimisht **Z. Arben Kallaçi,** administrator i Rajonit nr.4 i cili bën një prezantim të detajuar të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.4 të qytetit. Ndër të tjera ai përmend:

Blv.Mehmet Pashë Plaku.

- **RIVESHJE TOTALE ME ASFALT.** U punua për shtrimin me asfalt të ri të të gjithë segmentit duke shtruar të ri dhe duke krijuar sinjalistikën e përshtatshme horizontale dhe vertikale për përmirësimin e qarkullimit të mjeteve.
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.

- **INTEGRIM I KORSISË SË BIÇIKLETAVE.** U integrua korsia e dedikuar e biçikletave për të përmirësuar qarkullimin dhe lehtësuar trafikun duke i dhënë rëndësinë e merituar qytetarëve të cilët nuk lëvizin me makina.

Blv. Zogu I.

- **NDËRTIM I FASADAVE TË 22 PALLATEVE.** U përmirësuan si nga ana vizuale po ashtu edhe nga efiçenca energjitike 22 pallate duke vendosur kapotë në të gjithë fasadat e këtyre pallateve.
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.
- **KRASITJE E PEMEVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR.**

Rr. Daut Boriçi.

- **RIVESHJE TOTALE ME ASFALT.** U punua për shtrimin me asfalt të ri të të gjithë segmentit duke shtruar të ri dhe duke krijuar sinjalistikën e përshtatshme horizontale dhe vertikale për përmirësimin e qarkullimit të mjeteve.
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmiresuar ndriçimin në këtë segment.
- **INTEGRIM I KORSISË SË BIÇIKLETAVE.** U integrua korsia e dedikuar e biçikletave për të përmirësuar qarkullimin dhe lehtësuar trafikun duke i dhënë rëndësinë e merituar qytetarëve të cilët nuk lëvizin me makina.
- **KRASITJE E PEMËVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR.**

Rr. Hafiz Sabri Bushati.

- **RIVESHJE TOTALE ME ASFALT.** U punua për shtrimin me asfalt të ri të të gjithë segmentit duke shtruar të ri dhe duke krijuar sinjalistikën e përshtatshme horizontale dhe vertikale për përmirësimin e qarkullimit të mjeteve.
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.
- **INTEGRIM I KORSISË SË BIÇIKLETAVE.** U integrua korsia e dedikuar e biçikletave për të përmirësuar qarkullimin dhe lehtësuar trafikun duke i dhënë rëndësinë e merituar qytetarëve të cilët nuk lëvizin me makina.
- **KRASITJE E PEMEVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR.**
- **VENDOSJE SEMAFORI PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT.**

Rr. Besnik Sukja.

- **RIVESHJE TOTALE ME ASFALT.** U punua për shtrimin me asfalt të ri të të gjithë segmentit duke shtruar të ri dhe duke krijuar sinjalistikën e përshtatshme horizontale dhe vertikale për përmirësimin e qarkullimit të mjeteve.
- **SISTEMIM PUSETASH DHE KUNETASH**

Blv. Skenderbeu

- **VENDOSJE SEMAFORI PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT.**
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.
- **KRASITJE E PEMËVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR**
- **RIKUALIFIKIM I SHESHIT MES PALLATEVE (TEK MARKAGJONËT)**

Rr. Studenti.

- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.
- **VENDOSJE SEMAFORI PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT.**

Rr. Mehmet Gjyli.

- **INVESTIM PËR RIKONSTRUKSIONIN TOTAL TË RRUGËS.**
- **NDRIÇIM I PLOTË I RRUGËS.**

Rr. Edit Durham

- **KRASITJE E PEMËVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR**
- **INTEGRIM I KORSISË SË BIÇIKLETAVE.** U integrua korsia e dedikuar e biçikletave për të përmirësuar qarkullimin dhe lehtësuar trafikun duke i dhënë rëndësinë e merituar qytetarëve të cilët nuk lëvizin me makina.
- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmiresuar ndriçimin në këtë segment.

Sheshi Perash.

- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në këtë segment.

Sheshi Parrucë

- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmiresuar ndriçimin në këtë segment.

Rr. Mbreti Gent.

- **NDRIÇIM PUBLIK LED.** U zëvendësuan të gjitha shtyllat e vjetra të amortizuara me të reja dhe llambat e vjetra me të reja LED duke përmirësuar ndriçimin në ketë segment.
- **KRASITJE E PEMËVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR**

Rr. Pazarit

- **KRASITJE E PEMËVE SIPAS NEVOJËS DHE KOHËS SË PËRCAKTUAR**

Rr. Qafës.

- **MBJELLJE 31 PEMË.** U mbollËn 31 pemë në dy anët e rrugës përgjatë gjithë segmentit deri në degëzimin me Rrugën e Kalasë.

Rr. Bexhene (Degëzim)

- **NDRIÇIM PUBLIK.**

Ditët në vazhdim mendohet të fillojë puna për rikonstruksionin e plotë të Shkollës "Kol Idromeno" si dhe kopshtit që ndodhet pranë kësaj shkolle.
Në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Punëve Publike u mundësua zëvendësimi i kontenierëve të vjetër të grumbullimit të mbetjeve, me të rinj, në rrugët Daut Boriçi, Blv. Zogu I, Blv Mehmet Pashë Plaku, Rruga Studenti.

Fjalën e merr **Znj.Etleva Premçi**, banore në Lgj.Vekshar shprehet se:

- Problemi kryesor i zonës tonë mbetet rruga , pasi tani që fillon sezoni i shirave ajo bëhet e pakalueshme nga uji.
- Ka nevojë për kanalizime dhe ndriçim.

- Nga Ish tregu i ndihmave deri tek shkolla austriake ndriçimi nuk funksionon më, e njëjta gjë ndodh edhe sa kalon Hotel "Argenti deri tek nënstacioni i Draçinit."

**Z.Altin Salihi**, drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve publike përgjigjet se është punuar disa herë në ndriçimin e kësaj rruge por duhet të kemi edhe mbështetjen e banorëve pasi ka dëmtime edhe nga ana e tyre.

Edhe **Z.Bejleri** shprehet se rruga "Foleta" është në fazë projektimi pastaj do tenderohet dhe shuë shpejt do filloi puna.

**Z.Enver Dushi**, banor Lgj.Tepe thotë se:

- Kemi problem me infrastrukturën e rrugës pranë ish fabrikës së mëndafshit.
- Furnizohemi vetëm 2 orë në ditë me ujë të pijshëm.
- Rruga nga unaza për në Tepe ka prezencë të madhe uji, është e pakalueshme në dimër.

**Znj.Mimoza Zaja** , banore Lgj.Perash. Rruga "Dervishbeg" shprehet gjithashtu se:

- Nuk kemi ujë të pijshëm. vjen me orare. ( Nr.i kontaktit me UKSH. I padisponueshëm)
- Ploblem tjetër janë fasadat e pallateve. pasi bjen suvaja dhe duhet të ndërhyhet urgjentisht pasi përbën rrezik për banorët.

**Z.Ridvan Mujaxhi**. banor Blvd.Zogu I. Rruga "Musa Juka" shprehet se:

- Rruga është jashtë çdo standarti. duhet patjetër të ndërhyhet.
- Kemi një problem me një banor. i cili ka bllokuar hyrjen e pallatit me biznesin e tij.
- Rruga dalëse e pallateve tek Bar "Merci" është ngushtuar. nuk mund të kalojnë as makinat në rast nevoje.
- Ndriçuesat e vendosur kanë shpesh problem.

**Z.Kydret Shatza**,banor Lgj.nr.4:

- Rrugët vazhdojnë të jenë problem, pa kanalizime, pa ndriçim.
- Lokalet bllokojnë rrugët kryesore, duhet ndërhyrja e Policisë Bashkiake.
- Kemi mungesë uji të pijshëm.
- Fshatarët që shesin bllokojnë rrugët.

**Z.Sadetin**, banor në rrugën "Spahija" falenderon për investimin e bërë në rrugën e bërë në zonën e tyre por thekson se ka defekte dhe mungesë uji.

**Z.Bejleri** sqaron se rruga në fjalë është akoma brenda garancisë së firmës së ndërtimit prandaj për çdo defekt të konstatuar ajo mban përgjegjësi dhe është e detyruar ta riparojë.

**Z.Myzafer Shabani**, Rruga "Qafë" shprehet rruga është jashtë çdo standarti, s'ka as kanalizime dhe as ndriçim.

**Z.Bejleri** përgjigjet përsëri duke thënë se pozicioni i rrugës në kodër vështirëson shumë ndërhyrjen por kjo do jetë një nga prioritetet tona për buxhetin e vitit të ardhshëm.

**Z.Bashkim Sykja**, banor i Lgj. "Qafëhardhi" kërkon leje për suvatimin e pallatit ku banon. Ai dëshiron ta bëjë privatisht ndërhyrjen.

**Z.Kallaçi** përgjigjet se ne si administratë do ju ndihmojmë me procedurën e kërkuar për të përfituar lejen e ndërhyrjen.

**Z.Bardhyl Sokoli**, banor i Lgj. "Qafëhardhi"

- Problem është për ne tregu i ndihmave, tregëtarët që nga djegia e i tij tregtojnë përgjatë rrugës.
- Qendra shëndetësore nr.2 , bllokohet nga makinat aty dhe nga mbetjet e hedhura.
- Rruga e Vasijave ka mungesë kazanësh.
- Kemi probleme me ndriçimin.

**Znj.Antoneta Pero** merr fjalën dhe shpreh një shqetësim që ka komuniteti i pallatit ku ajo banon lidhur me një familje të komunitetit Rom. e cila është në vështirësi shumë të mëdha ekonomike. Familja është me fëmijë me probleme të shëndetit mendor. prandaj duhet asistuar patjetër nga drejtoria e Shërbimit social.

**Z.Josuf Hoti,** banor i rrugës "Bexhene" thotë se banorët e kësaj zone faturohen pa të drejtë për ujin. pasi ato furnizohen me puse dhe nuk kanë lidhje me ujësjellësin.

**Z.Alban**, banor në Lgj.Tepe shprehet se:

- Kemi probleme me ujin e pijshëm që na vjen me orar.
- Mungojnë kanalizimet, jemi akoma me gropa septike.
- Rruga e Tepes, rrugë 200 vjeçare është e pa asfaltuar.

**Z.Sokol Basha**, banor tek "Banja e vogël" thotë se ka një problem me ujërat e zeza. Ai shton se në atë zonë ka mungezë kanalizimesh dhe të gjithë ujrat e zeza kalojnë nëpër oborrin e tij. Situata është alarmante pasi kundërmon kudo dhe ka edhe mundësi sëmundjesh prandaj duhet gjetur një zgjidhje.

**Z.Alban**, merr fjalën përsëri duke thënë se tek Kalaja kemi problem me legalizimet e banesave sepse duke qënë zonë muzeale, ligji nuk është i njëjtë për përfitimin e legalizimit.Prandaj kemi nevojë për mbështetjen e Bashkisë për zgjidhjen e këtij ngerçi.
**Z.Muhamet Kaçiran,i** banor në Lgj.Xhabije, Blvd.Zogu 1. shprehet se:

- Kemi nevojë të ndërhyhet edhe në fasadat e pallateve parafabrikate të llagjes tonë.
- Duhen sistemuar telat e internetit dhe të rrjetit elektrik, pasi po sjellin shumë probleme tek banorët.

**Banor, rruga "Enver Draçini"** thotë:

- Kemi nevojë për shtim të 2-3 shtyllave ndriçimi.
- Kemi probleme me kanalizimet e ujërave të zeza.
- Duhet parë mundësia e shtrimit të sheshit në llagjen tonë dhe sistemimin e këndit të lodrave për fëmijë.

**Znj.Valbona Bardulla**, mësuese në shkollën speciale "3 Dhjetori":

- Kemi mungesa në bazë materiale.
- Kërkohet asistenca e një kujdestareje për disa fëmijë me nevoja të veçanta.
- Mungon rampa tek hyrja e shkollës.
- Axhensori nuk punon, prandaj duhet vlerësuar situata.

**Z.Leart Gushi**, banor Rr. "Besnik Sykja" shprehet se:

- Kemi probleme me parkimet pa kriter.
- Duhet mundësuar vendosja e një Bumi për arsye sigurie për banorët e zonës.
- Përveç tërheqjes së mbeturinave, duhet bërë edhe pastrimi (fshirja) e rrugës.

**Banor, "Rr.Mbreti Gent"** shprehet se:

- Problem kryesor për banorët e pallateve aty është kolektori i ujrave të bardha, rreth 23 m.
- Gjithashtu shqetësime kemi edhe për parkingjet e makinave.

**Z.Besnik Mlloja**, banor tek parafabrikatet në Perash thotë se:

- Duhet parë mundësia e ndërhyrjes në fasadat e pallateve tona me kapotë.
- Pemët duhen krasitur pasi krijojnë shpesh probleme dhe përbëjnë rrezik.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE:** Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"

***Njësia Administrative Lagjja nr.4***

***Datë:*** **25.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Enver Dushk | Tepe | | 0694546785 | |
| 2. | Berhan Dushi | Tepe | | 069 24 34 652 | |
| 3. | [illegible] | ~~[illegible]~~ | | 067 25 28 252 | |
| 4. | [illegible] | Qafe | | 068 22 79 476 | |
| 5. | Eliona Shkreli | Këshilltare | | 067 467 4716 | [signature] |
| 6. | Hyqret Shatku | Bregu i [illegible] | | 069 22 10 506 | [signature] |
| 7. | Rezarta [illegible] | [illegible] | | 0692437830 | [signature] |
| 8. | Ali Lezha | Qendra Kom. Egjiptian Rr. Fojletave | | 068 2314215 | |
| 9. | Efena Trena | | | 0672694410 | |
| 10. | Angjelin Matkola | | | 0695123813 | [signature] |
| 11. | Elearti Gjeçi | Rr. Desnik Sykja | | 0695121756 | [signature] |
| 12. | [illegible] | [illegible] | | 0680359[illegible] | [signature] |
| 13. | [illegible] | [illegible] | | 06925555 | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Eglis Salja | LGJ QAF | 0676677667 | | |
| 15 | Dritan Mugoni | Dragin i Vogël, Rruga Gavran Drosi [illegible] 068 22 63455 | | | |
| 16 | Helisa Lulashi | | | | |
| 17 | Monda Lulashi | | | | |
| 18 | Fatjon Balla | Qafa e Tilli | — | — | |
| 19 | Antonieta Pero | Xhabije | 0682259025 | antonjetapero@gmail.com | |
| 20 | Flavio Kollaxhi | Porok | 0692347564 | | |
| 21 | Ahmed Xhaferi | PERASH | 0693045414 | — | |
| 22 | Vllet Shpatini | Tepe | 0692027171 | | |
| 23 | Muharrem Tafe | Rrafe | 0682609858 | | |
| 24 | Donald Krugu | [illegible] | 0696122458 | — | |
| 25 | Xheuhir Ketanja | Xhabie Tophanë | 0683179582 | xheuhirketanja@gmail.com | |
| 26 | Sibel Nimoni | Tom Kola | 0696566107 | Sibelnimoni16@gmail.com | |
| 27 | Armedin Hosej | 2 vogë | 0677425658 | " | |
| 28 | Arsen Velaj | Perash | 069477378 | — | |
| 29 | Andri Vulaj | Perash | 069443116 | | |
| 30 | SOKOL VULAJ | PERASH | 0683069945 | — | |
| 31 | ARIF ÇOBAJ | PERASH | 0682216531 | — | |
| 32 | Lededin Çunga | Pijpc (Qendër) | 0692521227 | | |
| 33 | Kujtim Tafaj | Tarrnuc | 0693117530 | | |
| 34 | Irma Koplliku | Keshilltarë | 0695764166 | irme koplikuo@yahoo.com | |
| 35 | Valjeta Bajraktari | Keshilltarë | 067278449 3 | | |
| 36 | Barolf Sallaki | Qafa e Tilli | 0692190386 | Barolf Sallaki | |
| 37 | Muhamet Kacorri | Xhabije | 0684024601 | muhamet.kacorri@hotmail.com | |
| 38 | [illegible] | Rr. Mbret Bart | 0692556662 | | |
| 39 | Emanuela Motoj | Banja e Vogël | 0692461290 | emmotoj@hot.it | |
| 40 | Valbona Borodulla | Banja e vogël | 0698753859 | valbona.borodulla@gmail.com | |
| 41 | BESIM VUSMI | L.G. TEPE | 0692573317 | | |
| 42 | Ali Kraja | L.G. TEPE | | | |
| 43 | Silvia Bushati | Pelogeeusc Save The Children | 0689364048 | siljeta.bushatipjo@gmail.com | |
| 44 | DRINI BUSHATI | Bizuesmo 2000 | 0672020282 | drinus.bushati@gmail.com | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 45 | Myzafer Hidani | Qaf |  | 0676247551 |  |
| 46 | Anton Gonga | Qaf |  | 0682877701 |  |
| 47 | Bardhin Gjoka | Qaf. Arrall |  | 0683145153 |  |
| 48 | Sadok Bosha | Bojja Vogel |  | 251285 |  |
| 49 | Dritmira Gyrsiri | Lagja Dervish Beg | 069754472/ | dritmira_ze@yahoo.com |  |
| 50 | Besjon Zefi | lms/Kojani r... |  |  |  |
| 51 | Eduard Lufi | lms/Kojani r... |  |  |  |
| 52 | Vladimir Nika | K. Bashkiak |  |  |  |
| 53 | Lazer Pemaj | Ar.Ur. Sulade |  |  |  |
| 54 | Besmir Myftaja | Mehmet Plak | 06993 80584 |  |  |
| 55 | Armando Koci | Mehmet Pashplak | 069 8606 101 |  |  |
| 56 | PRITAN K.K.G. |  |  |  |  |
| 57 | MEHMET BEGA | Tepe | 069 27 08405 |  |  |
| 58 | SPARTAK GERR | Petrosh |  |  |  |
| 59 | Frenki Zedi | Luguçezme | 0683270734 | frenki555@gmail.com |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Rajoni nr.5

**Data :** *26.09.2024* **Ora :** *13.00* **Vendi:** Salla e Këshillit bashkiak.

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 43, nga të cilat 10 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për drafi projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr fillimisht **Z. Donika Ndoja,** administratore e Rajonit nr.5 e cila bën një prezantim të detajuar të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.5 të qytetit. Ndër të tjera ajo përmend:

**Infrastrukturë:**

- Shtruar me asfalt një segment i Rr. Pal Engjulli.
- Priten të fillojnë punimet në Rr, Gjon Gazulli (buxhetuar).
- Ndriçimi i ri Led si dhe zëvëndësimi i të gjitha shtyllave të amortizuara në Blvd.Skenderbeu , Rr. Edith Durham , Rr. Marin Beçikemi.
- Pritet fillimi i punimeve për mbylljen e të gjitha gropave.

- Do vendoset dhe ndriçimi në Rr. Luce Nishi (ku nuk ka patur ndriçim) si dhe në Rr. Dom Ndre Zadeja (sapo të mbarojnë punimet e pallatit të ri që po ndërtohet).

**Pastrimi dhe gjelbërimi:**

- Ne bashkëpunim me Ndërrmarrjen e Shërbimeve dhe Punëve Publike është bërë një punë shumë e mire në pastrimin e disa hotspoteve nga mbeturina dhe inerte kryesisht në Rr. Mark Ndou, Rr. 7 Shaljanët . Rr. Ded Gjon Luli.
- Lirimi dhe pastrimi i trotuareve nga shkurre dhe ferra që ishin bërë shumë problem për këmbësorët në Rr. Besnik Ceka (ish artistikja); në Unazën Lindore. Rr. Pal Engjulli dhe Rr. Kol Prela.
- Prerja në lartësi dhe krasitja e pemëve në Rr. Revolucioni Antikomunist Hungarez si dhe pastrimi para sheshеve të këtyre pallateve.
- Gjithashtu është bërë dhe lirimiiI hapësirave publike nga objekte të ndryshme.

Përsa i përket investimeve në shkolla do të fillojnë punimet për 2 fusha sportive në shkollën "Dëshmorët e Prishtinës" si dhe do bëhet riparimi i kaldajës në shkollën "Edit'h Durham".

Fjalën e merr **Z. Angjelin Zadeja,** banor i Lgj.5. Rr. Dom Lekë Zadeja, i cili shprehet se në rrugicën e tyre nuk është bërë asnjë investim. edhe pse ka bërë kërkesa pa fund. Ai shton:

- Problem është infrastruktura e rreth 70m rrugë.
- Mungon ndriçimi në zonë.
- Vazhdon të jetë problem pastrimi i mbetjeve. pasi kemi shumë biznese aty të cilët depozitojnë mbeturinat aty dhe nuk mjaftojnë kazanët aty.
- Në lagjen tonë kemi vetëm kanalizimet e ujrave të bardha. Duhet verifikuar situata për kanalizimet e ujërave të zeza.

**Z.Albert Marashi.** banor i rrugës "Fran Bardhi" shprehet se:

- Problem shumë shqetësues është amortizimi i rrugës. nuk ka kanalizime dhe ka prezencë ujërash të zeza, shqetësuese kjo pasi ka rrezik epidemie.
- Nuk ka as ndriçim , përfituese këtu janë rreth 60 familje.
- Edhe në rr.Roza Lejn dhe në rr. Martirëve është e njëjta situatë, emergjente për ndërhyrje.

Fjalën e merr **Zv/Kryetari Bejleri**, i cili thotë se është në dijeni të situatës në lidhje me problematikat e rrugëve në fjalë. Ai shton se këto dhe 2 rrugë të tjera në atë zonë janë objekt verifikimesh dhe evidentimesh për të llogaritur kostot dhe mundësitë për të kryer një ndërhyrje të plotë , që problemi të zgjidhet njëherë e mirë.

**Banor, Lagjia nr.5** ngre një tjetër shqetësim lidhur me tregtimin e peshkut në afërsi të restorant "Rozafa", gjë kjo që kryhet jashtë çdo standarti. Për më tepër aty ka edhe prezencë ujërash të zeza. Prandaj duhet parë me prioritet situata.

**Z.Mehmetaj**, banor i lagjes nr. 5 , tek pallatet e reja pranë fushës së druve shprehet se:

- Duhet ndërhyrë në fasadat e pallateve, pasi janë amortizuar.

- Kemi nevojë për një kënd apo shesh lojrash për fëmijët.
- Duhet verifikuar pastrimi i kontenierëve të mbeturinave.
- Kemi nevojë për asfaltim të rrugicave, pasi bëhen të pakalueshme kur ka shira.
- Duhet verifikuar sinjalistika rrugore ose të vendosen bume për kufizim shpejtësie sepse është zonë e rrezikshme.

**Z.Renato Çardaku,** banor i rrugës "Roza Lejn" sjell gjithashtu shqetësimin e banorëve të asaj rruge lidhur me infrastrukturën , pasi problemi është i përditshëm për rezidentët dhe ndërhyrja duhet të jetë prioritet.

**Znj.Mimoza Livadhi,** drejtoresha e shkollës "Edith Durham" përgëzon dhe falenderon për ndërhyrjet dhe investimet që janë kryer së fundmi në shkollën e saj. Ajo përmend ndër të tjera se ka filluar vendosja e paneleve diellore, është vendosur sinjalistika rrugore si dhe është punuar në ndriçim. Por ajo kërkon:

- Kemi nevojë të bëhet hidroizolimi i tarracës së shkollës.
- Duhet të mundësohet ngrohja me kaldajë.
- Kemi nevojë për lyerje të shkollës dhe të shihet mundësia që bëhet edhe për shkollat veshje fasade me kapotë.

**Banor, i Lagjes nr.5** shprehet lidhur me një shqetësim tek rruga e ujësjellësit. Aty është hapër një kanal dhe janë kryer punime por nuk është mbyllur. Është krijuar një gropë e madhe , e cila është kthyer në problem serioz dhe shpesh kanë ndodhur edhe incidente. Po ashtu nuk kemi as kanalizime të ujrave të zeza, të bardha. Duhet po ashtu të bëhet pastrimi i rrugës nga inertet që hidhen nga makinat e subjekteve ndërtuese.

**Z.Lulzim Kola,** banor në Lgj.Skenderbeg, rruga "Martirëve" shprehet se :

- Rruga është ngushtuar dhe është bërë e pakalueshme nga zjarrëfikeset në rast zjarri.
- Tubacionet e ujërave të zeza janë krejtësisht të amortizuara dhe kanë nevojë për ndërrim.
- Rruga është pa kanalizime dhe duhet të asfaltohet.

**Znj.Valbona Bregu**, drejtoreshë në shkollën "Ndoc Mazi" thotë se ka nevojë:

- Të rregullohen oborret e shkollës.
- Palestra e shkollës ka nevojë për ndërhyrje.
- Duhet të rishihet mënyra e ngrohjes së nxënësve .
- Duhet studiuar rajonizimi i nxënësve sepse për ulje numri nxënësish mësuesit po mbesin pa punë.

**Z.Gjon Dugila**, përfaqësues biznesi në Lgj.nr.5 merr fjalën dhe bën disa sygjerime lidhur me ndriçimin dhe ndërhyrjet në infrastruklturë. Ai shton se duhet promovohet më shumë turizmi. Prioritet duhen të jenë shkollat, kopshtet. Parkingjet duhen bërë me nivele, etj.

**Z.Antonio Shabani,** banor në Lgj.5, Rr. Edith Durham shprehet se në buxhetin e ardhshëm të bashkisë duhet parashikuar edhe asfaltimi dhe sistemimi i sheshit para shkollës "Martin

Camaj". Ai shton se nga kjo ndërhyrje preken direkt rreth 100 familje, duke përfshirë edhe 2 magazina institucioni dhe Zyrën Vendore Arsimore Shkodër.

- Tjetër shqetësim për banorët është edhe një tabelë në hyrje të lagjes. për ndalim qëndrimi në dy anë, prej të cilës shpesh herë banorët janë ndërshkuar pa të drejtë nga policia për parkim në lagjen e tyre.

**Znj.Alketa Karafili,** drejtoreshë në shkollën "Martin Camaj" dhe banore në Lgj.nr.5 përgëzon fillimisht për punët e kryera deri tani për qytetin por ndan të njëjtin shqetësim si parafolësi në lidhje me sheshin para shkollës. Ajo shprehet se:

- Sheshi para shkollës ka gjithmonë prezencë uji dhe është i pamundur kalimi.
- Kemi nevojë për sinjalistikë të shtuar rrugore.
- Shkolla jonë nuk ka as oborr dhe as fushë sportive.

**Z.Sokol Zaimaj**, drejtor i shkollës "Dëshmorët e Prishtinës" merr fjalën dhe thotë se na janë prezantuar disa projekte shumë të mira për shkollën tonë por ai konkretisht thotë:

- Shkolla është krejtësisht e amortizuar.
- Duhet bërë patjetër një tualet shtesë në katin e 3. të godinës, pasi të gjithë nxënësit përdorin banjon e vetme në katin e parë.
- Kemi nevojë për restaurime. lyerje etj. pasi në shkollën tonë nuk është ndërhyrë që prej vitit 1985.
- Duhet ndërhyrja e Policisë bashkiake për disiplinimin e parkimeve para hyrjes së shkollës.
- Gjithashtu pranë hyrjes së shkollës kemi një pusetë. që shumë shpesh shfryn jashtë dhe krijon probleme, edhe pse ndërhyhet herë pas here.

Të njëjtat shqetësime për shkollën ndan edhe **Znj. Erisa Rrustemi**, e cila thotë se ndërhyrjet e sipërpërmendura janë emergjente.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin:

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Lagjja nr.5***

***Datë:* 26.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Angjeline Shllaku | Shkodër | 0686640855 | angjeline_shllaku@yahoo.it | |
| 2. | Valbona Jolvizi | Shkodër | 0692034001 | valbona_begu@yahoo.com | |
| 3. | Eliana Shkreli | Këshilltore | 067467471C | | |
| 4. | Erisa Rrustemi | "D. e Prishtinës" | 0697380917 | erisabajni@hotmail.com | |
| 5. | Laura Egerci | "D. e Prishtinës | 0674087110 | lauraegerci@yahoo.com | |
| 6. | Sokol Zaimaj | "D. e Prishtinës | 0674060150 | zaimaj.sokol@gmail.com | |
| 7 | Gjergji Sokoli | D. ISh. Sh. Shkod | 0682080805 | gek.so.com | |
| 8. | Erjona Kocaku | Rajoni nr. 5 | 0699102603 | erjonakocaku@gmail.com | |
| 9. | Laureta Kiu | Kordinatore | 0696367108 | lauretakiu@gmail.com | |
| 10. | ELVIN HOXHA | SHKODER | 0694028418 | elvin.hoxha@idealisten.org | |
| 11. | Jonis Desku | Bashkia Shkoder | 0686541655 | | |
| 12. | ALTIN SHLLAKU | BASHKIA | 0682042990 | altushll@yahoo.com | |
| 13. | Adrian Doci | Shkoder | 0694477022 | | |
| 14. | Albi Culaj | Bashkia | 0694717977 | albiculaj@yahoo.com | |
| 15. | Eni Nalaj | Bashkia | 0692762665 | enalajeni@gmail.com | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| 16 | Albin Shoshi | Boshkia | 0672676866 | albinshosi@gmail.com | |
| 17 | Nikolin Sterkaj | NR. 5 | 0696965089 | nikolinsterkaj@gmail.com. | |
| 18 | Rozela Kamini | NR 5 | 0672062910 | strozela@yahoo.com | |
| 19 | Antonio Kamini | NR 5 | 0686979750 | antoniokamini@yahoo.com | |
| 20 | Fran Kodra | Nr 5 | 0688364885 | Fran Kodra | |
| 21 | Gezon Dibra | Nr I | 0692732747 | toni.ebozi@yahoo.it | |
| 22 | Mimoza Livalli | Nr 5 | 0672694898 | mimozalivalli@gmail.com | Për Posta Shkodër |
| 23 | Alketa Karafili | Nr 5 | 0674068359 | mentingame18@gmail.com | |
| 24 | Arben Mustafa | Nr. 5 | 0674080585 | benibmustafa@gmail.com | |
| 25 | ANRI TURHANI | Nr. 5 | 0684603042 | turhanianri@gmail.com | |
| 26 | Gjergj [illegible] | Nr. 5 | 0686279603 | | |
| 27 | MARKO [illegible] | Nr. 5 | 0672354249 | | |
| 28 | [illegible] | 5 | 0695123875 | | |
| 29 | Eduard [illegible] | Dom Nolo Zadeja | 0697664457 | — | |
| 30 | Angelin [illegible] | Dom Nolo Zadeja | 0682115003 | — | |
| 31 | Jetmir Koci | Pooj Skenderbeg | 0684107924 | kola.paljuri@gmail | |
| 32 | Gjon Delia | Lagjia Nr 5 | | | |
| 33 | Robert Verli | Lagja 3 Heroni | | | |
| 34 | Rezarta Pade | Sh. Kastrioti | 0692437830 | | |
| 35 | [illegible] | UKR Shkodër | | | |
| 36 | Gjon DUKGILAJ | TRADITA | 0682086056 | | |
| 37 | Albert Minarshi | Frang Bardhi | 0672543143 | albert.minarshi@hotmail.it | |
| 38 | [illegible] Gjergji | Frang Bardhi | 0692389907 | | |
| 39 | Reuda Gjordeli | Rozë Lagja Nr 5 | 0673512385 | reuda.gjordeli@gmail.com | |
| 40 | Pal Pepaj | Rr. Dom Nikoll Kaçorri | 0682333441 | palpepaj@yahoo.com | |
| 41 | Elis Camaj | 7 SHAKJANT | 0683113554 | eliscamaj@yahoo.com | |
| 42 | Antonio [illegible] | Nr. 5 | 0697384848 | | |
| 43 | Dodë Malukaj | R. Nr. 5. | 0692723227 | — | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik** : Njësia administrative Ana e Malit.

**Data** : *12.09.2024* **Ora** : *15.00* **Vendi:** Shkolla "Idriz Hoxha"

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 41, nga të cilat 7 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës** : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Flalën e marrin fillimisht Zv/kryetarja e Bashkisë **Znj. Teuta Qyteza** dhe zv/kryetari **Z. Rudin Beka,** të cilët falenderojnë të pranishmit për prezencën si dhe prezantojnë investimet e realizuara nga Bashkia Shkodër në njësinë Administrative Ana Malit përsa sa i përket infrastrukturës, kanaleve kulluese në zonë, ndriçimt publik si dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore.

**Z. Osman Musaja,** banor fshati Oblikë shprehet se:

- Ndriçimi në qendër të Oblikës mungon.

- Ka nevojë për sinjalistike të shtuar (Pasqyra) për kthesat përgjatë rrugës së Anës së Malit dhe Muriqanit.

**Z. Gëzim Lahi**, banor fshati Oblikë ngre shqetësimet e tij dhe të banoreve të pallateve në qendër të fshatit:

- Kërkojmë ndërhyrje në fasadat e pallateve.
- Nuk furnizohemi me ujë të pijshëm, vetëm 2 orë gjatë ditës.
- Në të gjithë Oblikën, matësit që janë vendosur, janë të pasiguruar.
- Ndriçimi tek pallatet Oblikë nuk funksionon.
- Kanali kullues pranë pallateve Oblikë ka nevojë për pastrim.

**Z.Sami Leka**, banor i fshatit Muriqan shprehet:

- Se në shkollat, ku s'ka fëmijë nuk ka pse të ketë investime.
- Çertifikimi i pronave akoma nuk ka përfunduar.
- Rruga Xhakaj ka nevojë për investim.
- Rrjeti elektrik në Muriqan nga OSHEE është shumë i dobët dhe ka
- shpesh probleme.
- Ujësjellësi i ri në Muriqan ka nevojë për menaxhim.

**Z. Ferid Hoti** merr fjalën dhe kërkon:

- Të behet pajisja me certifikata pronësie, sidomos tani që po fillon zbatimi i rrugës adriatiko- joniane.

**Banor,** fshati Garuc shprehet:

- Në rrugën nga xhamia Velinaj deri në Alimetaj duhen të vendosen bume pasi kjo rrugë ka rrezikshmëri të lartë.
- Duhet rishikuar edhe gjendja e përrenjve.

**Z.Xhevdet Kurti,** fshati Ana Malit shprehet:

- Rrugët kanë nevojë për ndërhyrje.
- Ka mungësë uji të pijshëm.
- Rrjeti elektrik ka shumë probleme. Shumë herë jemi pa dita gjithë ditës.
- Kemi nevojë për ndihmë edhe me legalizimet.

**Znj.Mri Shkambi**, banore e pallateve thotë se:

- Pranë pallateve të Oblikës ka nevojë për ndriçim.
- Pallatet janë totalisht të amortizuara.
- Të zgjidhet situata e pronësisë me pronat dhe banesat.

**Z.Ahmet Sulejmani,** banor i zonës përgëzon për ujësjellësin e Muriqanit. Gjithashtu ai shton:

- Të merren masa për pastrimin e ferrave.
- Kemi problem me energjinë elektrike.
- Edhe për tokat e papunuara duhet të ketë një qasje tjetër nga shteti për menaxhimin e tyre.

**Z.Marjan Quka,** banor i Obotit shprehet se jemi shumë të kënaqur me punën e bërë deri tani, me urat, tombinot dhe ndërhyrjet e bëra deri me tani në kanale. Ai shton se:

- Kemi problem me rrugën e Obotit, ku duhet të ketë dy – tre ndërhyrje për të lehtësuar kullimin e ujit kur ka përmbytje.

**Z.Skender Taipi**, mësues në shkollën "Qazim Mehja" përgëzon punën që po bëhet në restaurimin e të gjitha shkollave në njësinë e Anës së Malit.

**Z.Saimir Hoxha** merr fjalën dhe thotë se:

- Zona e Muriqanit nuk ka asnjë investim të kryer për rrugët.
- Me energjinë elektrike kemi vazhdimisht probleme.
- Rreth 6 km rrugë në Anë të Malit kanë nevojë urgjente të shtrohen.

**Z.Eduard Xhakaj,** banor lagjja Xhakaj. Muriqan shprehet se:

- Ana e Malit nuk ka çerdhe për fëmijët.
- Nuk kemi transport publik.

**Z. Rudin Beka,** Zv/kryetar i Bashkisë Shkodër sqaron në lidhje me transportin se kjo situatë është e njëjtë në të gjitha zonat e Shkodrës prandaj dhe jemi duke vlerësuar mundësinë që transporti të kryhet nga bashkia duke qënë se operatorët ekonomik nuk e mund ta ofrojnë këtë shërbim.

**Z.Osman Vataksi**, banor i zonës shprehet gjithashtu se:

- Mungon energjia elektrike.
- Rrugët kanë nevojë për ndërhyrje.

**Znj.Pode**, anëtare e Këshillit Bashkiak merr fjalën dhe thotë se duhet të caktohet një ditw për promovimin e zonës. Gjithashtu ajo shton se pranë ambjenteve të shkollës ndodhet dhe një muze, ku ka një shtypshkronjë që daton në 1483 dhe shumë artefakte të tjera të mbledhura në vite të cilat duhet të jenë të aksesueshme për publikun. Duhet të merren në ruajtje dhe të kemi mundësi t'i promovojmë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Ana Malit***

***Datë:*** **12.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Elsid Sadiku | Shkodër | 0693810646 | elsid.sadiku1@gmail.com | |
| 2. | Fatbardh Kuçi | Shkodër | 0676305001 | fatbardhkuci@yahoo.com | |
| 3. | Muhamed Vlashi | Muriqan | 0672831292 | | |
| 4. | Eni Noja | Muriqan | 0672853735 | Eni-1234@icloud.com | |
| 5. | Juriola Frroku | Muriqan | 0672808038 | juriola28@gmail.com | |
| 6. | Sumika Radoshku | Oblikë | 0672587671 | | |
| 7. | Griselda Bregu | Muriqan | 0696279836 | | |
| 8. | Lumnije Mallco | Oblikë | 0685334373 | | |
| 9. | Hatije Aleti | Oblikë | 0697429889 | ticinubu@gmail.com | |
| 10. | Suad Sadek | Oblikë | 0696939116 | SuadSadek01@gmail.com | |
| 11. | Luan Fasliqa | | | | |
| 12. | Mira Shkambi | Oblikë | 0683673888 | | |
| 13. | Hamit Hyka | Muriqan | 0672709456 | | |
| 14. | Eduart Teja D. | Xhakoj - Muriqan | 0672593344 | | |
| 15. | Osman Votoberi | Gradec Shtoj | 0674189528 | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16. | Maxjon Çeliaj | Obot | 0672694095 | | |
| 17. | Rakmi Feliktaj | Obot | | | |
| 18. | Qemal Muhsi | Oblikë | 0682255784 | | |
| 19. | Julzim Beqir | Alimetaj | 0677561251 | | |
| 20. | Sonni Kamo | Muriqan | 0672280364 | | |
| 21. | Alban Sekja | B. Shkoder | 0672082858 | | |
| 22. | Jozef Palua | B. Shkoder | 069245872N | palua.Jozef@gmail.com | |
| 23. | Adam Hyka | Oblikë | | | |
| 24. | Dritan Malja | Velimaj | 0693365174 | dritan_malje@hotmail.com | |
| 25. | Artur Ilkakaboj | Oblikë | | | |
| 26. | Ismet Hoxaaj | Muriqan | 0682098434 | | |
| 27. | Fatbim Bepaaj | Oblikë | 0692278760 | | |
| 28. | Kujtim Meti | Oblikë | 0699792187 | | |
| 29. | Fatmir Shalla | | | | |
| 30. | [illegible] | Velinaj | ~ | | |
| 31. | Nezir Hoxha | | | | |
| 32 | Xhevdet Kuti | Dramosh | 0696102534 | | |
| 33. | Totmir Tipica | Shtuf | | | |
| 34. | Lutfim Zekaj | Muriqan | 16 2 1963 | | |
| 35. | Skender Tonji | Shkollë Qender Velipojë | 0682420801 | skendertonji@gmail.com | |
| 36 | Sulejman Lala | | 0685224166 | | |
| 37. | Bashkim Dakaj | | 0682520023 | | |
| 38. | Sami Aliaj | | OOM | | |
| 39. | Allam Tenishi | Oblik Qender | 0694624280 | | |
| 40. | Muhane Kodra | Muriqan | | | |
| 41. | Farije Mehovic | Muriqan | | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Njësia administrative Bërdicë.

**Data :** *17.09.2024* **Ora :** *15.00* **Vendi:** Shkolla "Agim Tafili"

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 54, nga të cilat 7 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr administratori i njësisë administrative, i cili thekson faktin që vërehet një vëmendje e shtuar për zonën dhe liston një sërë investimesh dhe ndërhyrjesh të kryera në Njësinë e Bërdicës, ndër të tjera ai përmend:

- Rreth 2 km asfalt në zonen e Trushit.
- Rehabilitim i 8 km kanal ujitës.
- Ndriçim për rreth 1.3 km rrugë.

- Për të minimizuar problemet e përmbytjes janë ndërtuar 2 ura dhe 330 tombino në ndihmë të kullimit.
- Pastrim i kanaleve të dyta dhe të treta rreth 9 km.
- Mbjellje pemësh dhe shtim i gjelbërimit përgjatë rrugës Shkodër Velipojë.
- Shtrim i rreth 1.5 km me çakull në rrugët e fshatrave.
- Së shpejti fillojnë punimet për kanalet ujitëse.
- Gjithashtu i gjithë rrjeti ujitës i Berdicës do të rehabilitohet.

Edhe Kryetari i Këshillit Bashkiak **Z. Oltion Luli** shprehet Njësia e Bërdicës ka vemendjen e Bashkisë dhe kjo shihet nga realizimi i ndërhyrjeve të ndryshme në infrastrukturë. Ai shton se Njësia administrative e Bërdicës ka vlerat e veta dhe sjell të ardhura të konsiderueshme për Bashkinë Shkodër. Buxheti që hartohet fokusohet tek menaxhimi i shërbimeve, mbetjeve urbane, ndriçim, mirëmbajtjen e objekteve të shkollave apo kopshteve, të qëndrave shëndetësore si dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Fjalën e merr **Z.Sami Dani,** i cili shprehet se:

- Rezervuari është afër me fshatin por nuk kemi ujë të pijshëm sepse rrjeti është i amortizuar.
- Gjithashtu kemi nevojë për pastrim të kanaleve në zonë.

**Z.Albani Sekja,** specialist në drejtorinë e bujqësisë sqaron që puna për kanalet kulluese është në vazhdim.

- Në Rrugën Bërdicë –Velipojë, shton **Z.Dani,** na është marrë toka prej 7 vitesh dhe akoma nuk kemi marrë vlerat e shpronësimeve, kërkojmë nga ana e bashkisë të mbështesi për këtë.

**Z.Lulzim Mashi,** drejtor në drejtorine e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, sqaron duke thënë se procedura juaj ka marrë tashmë përgjigje, ajo ka përfunduar dhe është dorëzuar në Agjencinë e Shpronësimeve. Jemi në pritje të përgjigjes dhe akordimit të fondit nga ana e qeverisë.

**Banore, fshati Beltojë** thotë se ka vajzën 3 vjeç, e cila duhet të rregjistrohet në kopsht por nuk ka numër të mjaftueshëm të fëmijëve. Ajo kërkon një zgjidhje për këtë.

**Drejtoresha e shkollës "Agim Tafili"** shprehet se kopshti Beltojë dhe Malihebej janë mbyllur pasi nuk ka fëmijë. Megjithatë momentalisht kemi 9 fëmijë që kanë arritur moshën e kopshtit dhe duhet të gjindet një zgjidhje.

**Banore, fshati Bërdicë shprehet se:**

- Kemi problem me rrugën e Velipojës, përsa i përket mjetit të transportit të fëmijëve sepse ndalon larg nga banesat duke qenë se rruga e Trushit tashmë është me një kalim, problem ky edhe për të gjithë banorët e zonës, prandaj kërkojmë të rishikohet kjo problematikë.
- Në Bërdicë, rruga pranë njësisë administrativeka nevojë urgjent për riparim.

- Kemi dy rezervuarë në Bërdicë të mesme, të cilët duhen të shëmben pasi përbëjnë rrezikshmëri.
- Gjithashtu duhet parë mundësia e rrugëve dytësore që lidhin arat e tokat e punës me rrugën kryesore.

**Kryeplaku,** fshati Bërdicë e madhe shpreh shqtësimin e tij lidhur me:

- Rrugën në fshatin Bërdicë e madhe.
- Gjithashtu edhe ndërhyrjen në fushën e sportit.

**Z.Bejleri** përgjigjet duke thënë se Bashkia Shkodër po punon për planifikimim dhe realizimin e asfaltimit të rrugës së vjetër dhe lidhjen e saj me rrugën Velipojë – Shkodër. Gjithashtu së bashku me administratorin po verifikojmë mundësinë për hapjen e rrugëve të kalimit midis tokave të punës dhe rrugës kryesore.

**Z.Xhelal Myrtja,** kryetar fshati Bërdicë e mesme shprehet:

- Rruga që lidh Berdicën e madhe dhe të mesme është shumë e dëmtuar.
- Rruga e varrezave të vjetra (rruga e Mollajve) ka nevojë urgjente për ndërhyrje.
- Kemi një kanal prej 800 metrash i cili po pastrohet privatisht dhe ka nevojë urgjente për mbikqyerje.

**Kryetari i fshatit Beltojë** shprehet se në fshat kemi një sërë problematikash por kryesoret janë:

- Rruga e fshatit Beltojë ka nevojë për rikualifikim.
- Ujësjellësi që ka rrjet të amortizuar dhe nuk furnizohemi me ujë.

**Kryeplaku, fshati Trush** kërkon ndërhyrje urgjente në kanalin e lagjes, aty ka një përrua i cili mbledh ujërat dhe derdhet në Dri, janë kryer matjet por duhet filluar puna sa më shpejt. Gjithashtu kërkohet vendosja e një kolektori në lagjen Gj.Jakin ,që sjell ujin deri në fshat.

**Banore, fshati Trush** shprehet **se:**

- Duhet të rishihet rezervati i fshatit.
- Rruga e varrezave është problematike dhe duhet të riparohet.
- Të verifikohen me ujësjellesin kontratat pasi ka parregullësi.

**Banore,** lagjia Gjon Markaj thotë **se:**

- Duhet të shihet mundësia për ndërhyrje në lagjen "Gjon Markaj".
- Edhe kanali kullues ka nevojë për pastrim dhe verifikim.

Kryetari, fshati Mali Hebaj merr fjalën dhe shprehet:

- Duhet të kemi ndërhyrje në zëvendësimin e ndriçuesve në rrugë.
- Kemi gjithmonë probleme me ujësjellësin, pasi nuk ka asnjë investim në rrjet.

- Edhe rruga kryesore ka nevojë për sinjalistikë, që mos të lejohet kalimi i kamioneve në këtë rrugë pasi përbën rrezik për banorët e zonës.

Drejtoresha e shkollës "Frederik Gjoni " gjithashtu shprehet se në shkollën që ajo drejton nuk ka pasur ndërhyrje që në 2011. Ajo shton:

- Kemi nevojë që të kryhet rrethimi i shkollës.
- Dyert dhe dritaret janë emergjente.
- Kemi nevojë për punonjës shërbimi për mirëmbajtjen e oborrit dhe mjediseve të shkollës.

Ajo gjithashtu thotë se shkolla ka rreth 320 fëmijë dhe është e nevojshme të kryhen disa ndërhyrje në mirëmbajtjen e shkollës. Shkolla shërben edhe si qendër komunitare dhe zhvillohen shumë kurse, por kemi probleme me transportin e mësuesve, i cili duhet të mbulohet nga Bashkia. Kërkojmë po ashtu të angazhojmë nxënësit tanë në aktivitetet që zhvillon Bashkia.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Bërdicë***

***Datë:*** **17.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gazmend Rexha | | | | |
| 2 | Bujar Ferracaku | Berdice e Siperme | 0674617508 | bujarferracaku@yahoo.com | |
| 3 | Violeta Hoxha | Bërdice e Mesme | 0698886186 | violetahoxha29@yahoo.com | |
| 4 | Besë Pëllumbi | Trush | 0676343107 | besepellumbi1@gmail.com | |
| 5 | ANILA BARBULLUSHI | DREJTORI Nr. 10 | 0674060881 | anilabarbullushi78@gmail.com | |
| 6 | [illegible] Tomore | Beltoj | 0673136679 | | |
| 7 | Fatmir Ojni | Berdicë e Sipërme | 0673439831 | - - - - - | |
| 8 | Gjergji Gjokaj | [illegible] | 0695577446 | - - - - - | |
| 9 | Ender Meti | Berdicë e Sipërme | 0674134050 | - - - - - | |
| 10 | Haki. Mustafa | Trush | 0692098604 | | |
| 11 | Qultim Mustafa | Trush | 069947334 | | |
| 12 | Bezim Sole | | 0695469406 | | |
| 13 | | | | | |
| 14 | Dramil Tojni | Berdicë | | | |
| 15 | Shkelqim Brahim | Trush | 0682562999 | — | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Besim Geci | Taush | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | [illegible] | Bërdice | | | |
| 19 | Gjergj Gjergji | | | | |
| 20 | [illegible] | | | | |
| 21 | [illegible] | | | | |
| 22 | [illegible] | | | | |
| 23 | [illegible] Rusi | | | | |
| 24 | [illegible] | | | | |
| 25 | [illegible] | | | | |
| 26 | [illegible] | | | | |
| 27 | [illegible] Gjergji | | | | |
| 28 | [illegible] | Bleqi [illegible] | 0683057666 | | |
| 29 | [illegible] | | | | |
| 30 | Edison Dimi | | | | |
| 31 | Arsen Bardice | | | | |
| 32 | Ismir Geci | | | | |
| 33 | Silvester Smihaj | | | | |
| 34 | Sebastian Smihaj | | | | |
| 35 | Tofik Brahimi | | | | |
| 36 | SAMUEL VEKAJ | | | | |
| 37 | [illegible] Dushmani | | | | |
| 38 | Salih [illegible] | | | | |
| 39 | [illegible] | | | | |
| 40 | [illegible] Mexha | | | | |
| 41 | [illegible] | | | | |
| 42 | [illegible] | | | | |
| 43 | [illegible] Nika | | | | |
| 44 | [illegible] | | | | |
| 45 | [illegible] Hasani | | | | |
| 46 | Fatlum Cafi | | | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 47 | Andi Brahimi | Tresh | 0673828000 | AndiBrahimi@[illegible] | [signature] |
| 48 | Elion Hoxha | Bardhaj | 0699757300 | [illegible]@[illegible].com | [signature] |
| 49 | Rezarta Bode | Keshilltare | 0692437830 | | [signature] |
| 50 | Eliona Mucaj | Keshilltare | 0674674716 | | [signature] |
| 51 | Polok Tomo | Belto | 0693322[illegible] | | [signature] |
| 52 | ELSID XHLOGA | Bardhaj | 06772063[illegible] | | [signature] |
| 53 | Nik Lorja | Bardhaj | | | |
| 54 | GJERGJ DUSHAJ | BARDHAJ | 0673079789 | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

# PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

## "DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".

**Konsultim publik** : Njësia administrative Postribë.

**Data** : *18.09.2024* **Ora** : *13.00* **Vendi:** Pranë Njësisë administrative.

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 26, nga të cilat 4 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për drafi projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Kryetari i Këshillit **Z.Luli** hap takimin duke thënë se Bashkia Shkodër ka vëmendje të shtuar sa i përket investimeve dhe punëve të ndryshme në përmirësim të jetës së qytetarëve. Fokusi i diskutimeve në këtë takim lidhet me funksionet që mbulon Bashkia siç janë: menaxhimi i shërbimeve publike, grumbullimi e transporti i mbetjeve, ndriçimi, gjelbërimi, mirëmbajtja e objekteve të arsimit parashkollor dhe arsimit 9-vjeçar dhe të shkollave të mesme, menaxhimi i ndihmës sociale si turizmi kulturor dhe natyror që ofron Njësia administrative e Postribës.

Kryetari i njësisë administrative **Z. Brahimataj** paraqet disa nga punët e realizuara:

- Është realizuar pastrimi i hotspoteve.
- Pastrimi i segmenteve rrugore nga ferrat dhe sistemimi i karregjatave.
- Është sistemuar kanali kullues në Drisht.

- Ura e Mesit është rikonstruktuar.
- Ka filluar puna për këndin sportiv në shkollën "Adem Haxhija".
- Kanë filluar punimet për rrjetin e ujësjellësit në fshatin e ri.

**Z.Ardjan Spahia,** kryetari i fshatit Boks shprehet se :

- Kemi disa nevoja sa i perket kanaleve të vaditjes dhe kërkojmë që të ndërhyhet pasi janë të demtuar dhe kanë nevojë për pastrim dhe rehabilitim.
- Shume segmente rrugore në fshatin Boks paraqesin rrezikshmëri për kalimin e rrugës, sidomos për fëmijët. Duhet parë mundësia për sinjalistikë.
- Ndriçimi në fshatrat e zonës së Boksit mungon.
- Edhe me ujësjellësit kemi problem, pasi nuk ka ujë të pijshëm.(ujësjellësi Rrasek)
- Në fshatin Kodër Boks ka nevojë për ndërtimin e lerave të ujit në zonë.

**Kryeplaku i fshatit Dragoç** merr fjalën dhe thotë:

- Duhet të hiqet rrjeti elektrik, që kalon mbi shtëpitë në lagjen Çelaj, pasi është me shumë rrezik.
- Kemi problem me një nga kanalet vaditëse në zonën e Dragoçit,duhet verifikuar situata.
- Mungon ndriçimi publik në fshatin tonë.
- Rruga qendër Dragoç është e gjitha me gropa dhe e pasistemuar.
- Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza mungon dhe banorët i shkarkojnë këto ujëra në kanalet vaditëse e kulluese.
- Duhen verifikuar kanalet ujitëse në zonën e Postribës pasi janë në kushte jo të mira.

**Z.Curri, banor** fshati Drisht shprehet se:

- Shkolla ka nevojë urgjente për ndërhyrje në infrastrukturë.
- Ka filluar vendosja e matësave për ujin, por rrjeti në këtë zonë është me tuba çeliku dhe nuk funksionon më, prandaj duhet investim nga ana e Bashkisë për sistemin e ujësjellësit.
- Vazhdojmë të kemi probleme me rrjetin elektrik.
- Kanalet sekondare në Dragoç dhe Boks kanë nevojë për realizim të investimeve të parashikuara për të patur ujë për vaditje.

**Kryetari i fshatit Myselim** gjithashtu thotë:

- Kemi nevojë për vendosje në funksion të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm , pasi rrjeti është i instaluar por ka nevojë që të kryhen kontrolle dhe riparohen ato defekte që mund të ketë.
- Duhet ndërhyrë në kanalin e Shtodrit, në rrjetin e furnizimit.
- Gjithashtu edhe rruga e fshatit mungon dhe ka vite që nuk ndërhyhet.
- Mungon ndriçimi publik dhe gjatë natës është zonë e rrezikshme.

**Z.Rifat Brahimataj,** kryetar i fshatit Mes shprehet se:

- Ujësjellësi në fshatin tonë nuk funksionon dhe ka nevojë të ndërhyhet.

- Rruga lidhëse Mes - Myselim gjithashtu mungon.
- Është me shumë rëndësi ndërhyrja në kanalin e Shtodrit.

**Banore, fshati Boks**

- Kemi 2 vite që presim për furnizimin me ujin e pijshëm dhe akoma nuk është bërë asgjë.
- Kryepleqtë e lagjes duhet të monitorojnë më tepër punët dhe dëmtimet që bëhen në terren.
- Ka nevojë për shtim të koshave të mbeturinave.
- Gjithashtu duhen pastruar kanalet dhe kulluese.

**Banore, Ura e Shtrejtë thotë se:**

- Mungon totalisht ujësjellësi.
- Vaditja gjithashtu mungon.
- Rruga Ura e Shtrenjtë - Prekal është shumë e ngushtë dhe minimalisht duhet të krijohen xhepa për kalimin e makinave.
- Edhe zona e fshatit të ri ka të njëjtat problematika lidhur me ujësjellësit dhe kanalet vaditëse dhe kulluese.

**Z. Fatmir Lisaj,** kryetar fshati Vilez.

- Jemi fshati më i varfër dhe kemi disa nevoja të domosdoshme.
- Ka nevojë për ndërhyrje një rrugë rreth 6 km, e cila është kalldrem dhe lidh Gurin e zi me Shllakun. Është rrugë me shumë potencial turistik dhe ndihmon edhe banorët e zonës.
- Shkolla e fshatit Vilez është drejtë amortizimit total.nuk ka as energji elektrike as ujësjellës.

**Z. Kristjan Vuksani,** banor fshati Prekal.

- Në fshatin Prekal janë 15 shtëpi që kanë nevojë për një Urë për një distancë të vogël rreth 30 metra,
- Nuk kemi qendër shëndetësore dhe mund të krijohet një ambjent për këtë mund pranë shkollës.
- Gjithashtu në Prekal shumë problematike është mungesa e ujit. Nuk kemi as ujësjellës, as kanale vaditëse
- Është zonë turistike dhe uji duhet të jetë parësor.

**Z. Kujtim Uruci,** banor fshati Domen shprehet se:

- Makinat e tonazhit të rëndë që kalojnë gjatë rrugës për në Domen kanë dëmtuar shumë rrugën, duhet gjetur një alternativë.
- Rreth 2 km rrugë mungojnë krejtësisht.
- Mungojnë tubat vaditës.
- Rruga për në shkollën e fshatit duhet të rehabilitohet.

**Z. Avenir Çelaj** , banor fshati Dragoç shprehet po ashtu se:

- Në zonën tonë nuk është bërë asnjë investim.

- Ka nevojë për kanalizime.
- Uji i pijshëm mungon dhe asnjë punim tjetër nuk është kryer.
- Kërkojmë që të ketë vëmendje më të madhe për zonën tonë.

**Z. Bushaj,** banor fshati Kullaj:

- Kemi nevojë për vendosje "bumash" rrugës së fshatit Kullaj sepse ka shumë rrezik për fëmijët dhe kalimtarët.
- Koshat e mbeturinave duhen pastruar me shpesh.
- Mungon ndriçimi në rrugën qendër Kullaj deri tek shkolla.
- Rruga drejt fshatit Kullaj ka nevojë për riparim.
- Duhet të shihet mundësia e vazhdimit të investimit për rrugën Dragoç – Kullaj.

**Kryetari i fshatit Kullaj** shprehet se:

- Qendra shëndetësore është e degraduar dhe duhet ndërhyrë.
- Shkolla fillore është mbyllur për mungesë nxënësish.
- Ka nevojë për ndërhyrje në kutitë e shpërndarjes së ujit dhe matësat.
- Duhet të ndërhyhet në rrugët dytësore në fshatrat e zonës Kullaj.
- Gjithashtu kanë nevojë për pastrim dhe rindërtim kanalet vaditëse në Dragoç dhe Kullaj.
- Duhet parë mundësia e zgjerimit të rrugës së fshatit.

**Z. Xhevahir Bushaj,** banor fshati Kullaj merr fjalën dhe shprehet se në lagjen Sume rruga është e amortizuar krejtësisht dhe është i pamundur kalimi me makinë. E njëjta gjë edhe me rrugën që lidh me Gucinë.

**Banore, fshati Vilez** sugjeron ngritjen e një grupi pune që të shoh në terren problematikat e ndryshme sepse vetem kryetari i njësisë administrative nuk mund ta mbuloj të gjithë zonën. Ajo shton:

- Rruga Vilez ka nevojë për shtrim dhe mirmbajtje pasi ka plot turistë që e frekuentojnë këtë rruge.
- Shkolla ka rreth 10 – 11 nxënës dhe ka problematika plot, por minimalisht duhet lidhur kontrata e dritave sepse duke qenë se nuk ka dokomenta pronësie nuk ka as energji.
- Shqetësim tjetër janë edhe gjobat e policisë bashkiake për tregtarët në rrugë.

**Z. Enver Buhaj,** banor fshati Mes shprehet se:

- Rruga pranë shkollës është shumë e rrezikshme për fëmijët prandaj duhet verifikuar situata.
- Në rrugën e Hotit nuk funksionojnë instalimet elektrike për ndriçimin publik.
- Duhet vendosur sinjalistikë kur punohet në rrugët e ngushta.
- Në rrugën Stom Golem - Ura e Mesit ndodhin shumë aksidente dhe ka nevojë të të gjendet një zgjidhje, ndoshta me sinjalistikë.
- Përpara shkollës Adem Haxhija ka nevojë për hapësirë për parkim ose për lulishte dhe mjedis publik.
- Nuk ka tabela sinjalistike për fshatrat, mungojnë kudo.
- Shqetësim tjetër janë edhe mbifaturimet e bëra nga ujësjellësi në fshatin Dragoç.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

______________________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE**: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"

***Njësia Administrative Postribë***

*Datë:* **18.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Rezarta Bode | Këshilltare | 0692437830 | | |
| 2. | Eliona Shkrela | Këshilltare | 0674674610 | | |
| 3. | Bujar Bajraktari | Bok Postribë | 0676358044 | bujarbajraktari23@outlook.com | |
| 4. | Hilda Mema | Ura Shtrejt | 0672950079 | | |
| 5. | Justin Uruçi | Domën | 0675243788 | | |
| 6. | Fatmir Lici | Kajelo Fshat | 0682211178 | | |
| 7. | ISREF VELIJA | MYSELIM | 0673834530 | | |
| 8. | Artan Spahija | Boks | 0676542484 | | |
| 9. | [illegible] | Mes | 0695323741 | | |
| 10. | Gurgena [illegible] | Këshilltare | 0677388105 | | |
| 11. | [illegible] | Drisht | 12-2-1858 | | |
| 12. | [illegible] Brahimaj | Mes | | | |
| 13. | [illegible] | Dragoç | 1959 | | |
| 14. | | | | | |
| 15. | ARSENAD BRAHIMATAJ | ME | 00447555252751 | NADI_MES@HOTMAIL.COM | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Azbi Bushaj | Kullaj | 0699104700 | | [signature] |
| 17. | SILDI SPAHIUJAJ | Dragoc | 0685707418 | | [signature] |
| 18. | VLADIMIR HASAJ | DRAGOÇ | 0676929390 | | [signature] |
| 19. | Vesel [illegible] | BOKES | 0692384028 | | [signature] |
| 20. | Emin Bushaj | Boka | 0684591472 | | [signature] |
| 21 | Mirjam Repaj | BOKS | 0676535255 | | [signature] |
| 22 | Hysbia [illegible] | Orosh | | | |
| 23 | Avenik Celaj | Dragoc | 0683222555 | | |
| 24 | SHEMSI KARMAJ | RRASHK | 0673822990 | | [signature] |
| 25 | Shpetim Velija | Mjedim | 0673438659 | | [signature] |
| 26. | XHEVAHIR UBUSHAJ | SUK KULLAJ | | | [signature] |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".**

**Konsultim publik :** Njësia administrative Rrethina, Pult, Shalë, Shosh.

**Data :** *11.09.2024* **Ora :** *13.00* **Vendi:** Pranë Komunës

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 93, nga të cilat 19 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr **Kryetari i fshatit Dobraç**, i cili shpreh shqetësimet e zonës së tij:

- Rruga nga shkolla tek SMT në Dobraç është e amortizuar totalisht dhe ka nevojë për ndërhyrje.
- Tubacionet e ujit të ujësjellësit në zonën e Dobraçit kanë nevojë për ndërhyrje pasi janë të dëmtuar.
- Shkolla e fshatit ka nevojë për ambjente shtesë për t'i shërbyer më së mirë nxënësve të zonës.

- Ka nevojë të kryhet edhe pastrimi i kanaleve, pjesa nga Dobraçi tek serat (ish SMT) dhe serat në Golem.
- Kërkojmë vendosjen e bumeve në rrugën pranë kishës, tek murgeshat dhe pranë kopshtit të fëmijëve.
- Ka nevojë për shtim të ndriçuesve dhe ndryshim të atyre të dëmtuar.
- Nga Shkolla "Isa Jakupi" deri në Golem ka mungesë totale të ujit prandaj duhet të ketë vëmendje të shtuar nga ndërmarrja e ujësjellësit.

Drejtoresha e shkollës Dobraç **Znj.Ermira Çeliku,** shpreh shqetësimet ë shkollës që drejton:

- Shkolla Dobraç ka 8 klasa me 104 nxënës në total dhe ka nevojë për shtesë në infrastrukturë sepse nuk ka sallë për këshillin pedagogjik apo ambjente te tjera rekreative për mesuesit apo nxënësit (p.sh: bibliotekë, ambjente për studime etj). Është e realizueshme pasi prapa shkollës ka hapësirë të mjaftueshme për shtesë.
- Në godinaën e kopshtit Dobraç pikon çatia dhe ka nevojë për izolim , po ashtu të shihet mundësia e një rubinet uji aty.

**Z. Shpetim Lekaj,** banor fshati Golem:

- Uji i pijshëm mbetet problem në zonën e Golemit (pranë Blu Sky) aty është kolektori që furnizon qytetin e Shkodrës, por zona përreth nuk ka ujë. Ka nevojë për shtesë tubacioni prej 500 metrash për të furnizuar lagjen me ujë të pijshëm.
- Rruga pranë gomisteri "Visi" ose pranë fushës së sportit, ku bëhet stërvitja nga ekipe të ndryshme ka nevojë për ndërhyrje.
- Po ashtu edhe rruga pranë market "Hysaj" ka nevojë për ndërhyrje dhe rikualifikim.

**Kryetari i fshatit Nemavriq**, Njësia administrative Shalë shprehet:

- Rrugët dytësore në fshatin Nemavric kanë nevojë për ndërhyrje.
- Në zonën aty ka mbifaturime dhe probleme të shumta nga OSHEE.

**Z.Ndoc Fusha,** kryetari i fshatit Bleran, Bardhaj flet për kerkesat e banorëve të zonës së tij:

- Ura e Bardhajve riparohet herë pas here , por mbetet me një kalim, prandaj duhet kryer një ndërhyrje më afatgjatë dhe të jbëhet me dy kalime.
- Nga kryqëzimi i shkollës deri në qendrën e fshatit ka probleme me rrugën, pasi është e amortizuar dhe duhet bërë pastrimi i ferrave.
- Rrugët e zonës Bardhaj kanë të gjitha nevojë për ndërhyrje dhe rikualifikim.
- Linjat elektrike në Bleran janë krejtësisht të amortizuara.
- Uji i pijshëm vazhdon të mungojë në Bardhaj.
- Kanalet e zonës së Bleranit dhe Bardhajve kanë nevojë për pastrim.
- Zona e fshatit Bardhaj ka nevoja të shumta sepse ka vite pa i bërë asnjë investim.

Fjalën e merr **drejtoresha e shkollës Shtoj i Ri** dhe ngre shqetësimet e shkollës që drejton:

- Kemi nevojë që të lyhet shkolla dhe kryhet mirëmbajtja e ambjeteve të shkollës.
- Kemi nevojë për të shtuar mjedise të reja, për këshillin pedagogjik , për kabinete dhe për ambjente rekreative. Nevojiten 6 ambjente të tjera sepse kemi 9 klasa dhe duhen edhe 3 klasa te tjera sepse kemi 109 nxënës.
- Shkolla nuk ka ambjente sportive .
- Terraca e kopshtit ka nevojë për hidroizolim.

**Znj.Arjona Nikolli,** drejtoreshë e kopshtit, Rrethina

- Arsimi parashkollor ka akoma shumë nevoja, por një kërkesë nga prindërit e fëmijëve të kopshteve është që të hapen kopshte me drekë sepse një shërbim i tillë është nevojshëm për prindërit pasi janë në punë.
- Kemi një numër të lartë të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet, prandaj duhet parë mundësia e një kopshti me drekë për të gjithë zonën.

**Banor,** fshati Grudë e Re shprehet:

- Kemi nevoja të shumta për ndërhyrje në rrugët e fshatit.
- Kemi problem me furnizimin me ujë të pijshëm.
- Kemi nevojë për kënde lojrash, hapsira për të moshuarit në qendrat e fshatrave.

**Z.Arsid Pirani**, fshati Guci e re merr fjalën dhe shprehet:

- Rruga që lidh fshatin Guci me rrugën kryesore është e pakalueshme.
- Rruga e Vorrezave vazhdon të mbetet problem përsa i përket infrastrukturës.
- Duhen pastruar dhe sistemuar kanalet vaditëse.
- Kemi nevojë për linjë urbane.

**Znj. Lindita Hajdari,** drejtoreshë kopshti Golem thotë:

- Kemi nevojë për ndriçim brenda shkollës.
- Oborri i shkollës ka probleme sa herë që bie shi.
- Ambjentet e kopshtit nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për 34 fëmijë.
- Nuk kemi vend për magazinimin e druve për ngrohje.

**Znj.Mirela Mataj**, fshati Shtoj shprehet:

- Problematike mbetet rruga për tek varrezat e Shtojit të Ri.
- Po kryhen punime nga Ujësjellësi por po dëmtohet rruga nga punimet.
- Koshat e plehrave ndodhen para shkollës dhe duhet gjetur një tjetër sistemim për to.

- Të ketë vëmendje të shtuar edhe për shkollat e fshatit, duhet të jenë me të njëjtin standard si shkollat e qytetit.

Merr fjalën **Z. Ardjan Kraja** , banor i fshatit Golem, i cili ngre shqetësimet e tij si më poshtë:

- Shkolla e Golemit ka çati me llamarina dhe duhet të rikualifikohet.
- Duhet të ndërhyhet në rrugën nga Kopliku për në zonën industriale.
- Dy ura në fshatin e Golemit janë të dëmtuara.
- Ndriçimin në zonë e kemi investuar shpesh vetë. rreth 70% e rrugëve janë të pa ndriçuara

**Banore**, fshati Grude shprehet:

- Rruga e Vinotekës ka nevojë për ndërhyrje.

**Kryeplaku** i fshatit Zues shprehet:

- Stacioni i ujit të pijshëm në Zues ka nevojë për ndërhyrje. Duhet një pompë uji me kapacitet më të madh.
- Duhet të ndërhyhet në rrugën për tek stacioni i ujit të pijshëm rreth 160 metra.
- Duhet të verifikohet mundësia për pastrim dhe sistemim e përroit në fshatin Zues.
- Në fshatin Zues duhet të ketë ndërhyrje për shtim ndriçuesish.
- Pritat malore (pranë varrezave të fshatit) kanë nevojë për investim.
- Rruga përpara shkollës Zues duhet riparuar.
- Ndarëset e rrugës pranë ish fabrikës së qimentos janë shumë të ngushta dhe këmbësorët kanë vështirësi kalimi.

**Z. Berhan Erkoci**, banor fshati Zues thotë se:

- Në qendër të fshatit Zues, dy rrugë rreth 70 metra kanë nevojë për asfaltim.

**Kryetari i fshatit** Hot i Ri shprehet se zona ka shumë probleme por me prioritet jane:

- Ndriçimi i rrugës kryesore.
- Shtrimi i rrugicave, sidomos rruga e varrezave që është shumë e nevojshme.

**Banor,** fshati Shtoj i Ri shprehet:

- Në Shtoj të ri dhe në Shtoj të vjetër kemi probleme të vazhdueshme me OSHEE për rrjetin e furnizimit.
- Rrugët në Stom Golem, pranë repartit ushtarak dhe rruga kryesore ka shumë banorë dhe ka nevojë të madhe për ndërhyrje.

**Drejtoresha e shkollës** "Tring Smajli" thotë:

- Rruga nga Fermentimi për tek shkolla është në gjendje të keqe dhe ka nevojë urgjente për ndërhyrje.

**Banor** , fshati Grudë

- Nga varrezat e Grudës deri tek varrezat e qytetit ka një ndarje me mure që nuk lejon kalimin. Do ishte mirë të verifikohej mundësia të hapet një rrugë kalimi aty për të na lehtësuar aksesin për tek varresat.
- Fshati Grudë ka shumë rrugë që kanë nevojë për ndërhyrje.

**Z.Onid Bejleri**, Zv/Kryetar i Bashkisë Shkodër informon të pranishmit për punimet e kryera dhe ato që janë në proçes dhe në plan për tu investuar së shpejti.

Fjalën e merr **Z. Mikel Kopsaj,** administrator i Njësisë Shalë, i cili shprehet:

- Rrugët e fshatrave 35 km rruge kanë nevojë për ndërhyrje.
- Aksi Nderlysaj - Theth nuk ka mirëmbajtje në 6.3 km rrugë.
- Shkolla e mesme në Breg Lumi "Mehmet Shpendi" ka nevojë për restaurim ose spostim pranë qendrës shëndetsore.

**Banore,** fshati Grudë thotë se:

- Në zonën e Grudës nuk ka ujë të pijshëm.
- Rrugët në Grudë, sidomos ajo pranë shkollës kanë nevojë urgjente të rregullohen.
- Edhe në fshatin Shosh nuk ka as mirëmbajtje rruge, nuk ka as qendër shëndetësore, as shkollë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka ,**Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Rrethina, Pult, Shalë, Shosh.***

***Datë:* 11.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | A. SALIHI | | 0682242980 | alisalih@yahoo.com | |
| 2. | A. Ndershtyoj | Grude e Re | 0685226352 | | |
| 3. | Vh. Hoti [illegible] | Ardho... | 0672060066 | | |
| 4. | Fatbardh Kuz | Shkodër | 0676705001 | fatbardhkuz@yahoo.com | |
| 5. | Elvid Sadiku | Shkodër | 0693810646 | elvid.sadikn_1@gmail.com | |
| 6. | Dede Vuksani | H/ AD. Shalë | 0682293310 | | |
| 7. | Kolë Hadoj | N/ AD Shalë | 0682424704 | | |
| 8. | Kol Dragaj | Nicaj Shalë | 0675336077 | | |
| 9. | Astrit Vladaj | Pecaj Shalë | 0684046555 | | |
| 10. | LEKE PEPNIKU | KAPRRE | 0685002939 | | |
| 11. | Ylli Prroclcoj | Theth | 0698101581 | Ylli.Prroclcoj1@gmail.com | |
| 12. | Pllumb Sopsa | Lekaj | 0684142282 | | |
| 13. | Mikel Topsaj | Pecaj | 0696221919 | mikeltopsaj@yahoo.com | |
| 14. | Marash Marku | Nicaj | 0692844735 | | |
| 15. | Kole Gjelosh | Vukbana | 0673580118 | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16. | Zefe Ali | SHOSH | 0682324968 | — — | |
| 17. | Trok Bota | [illegible] | 0682419861 | | |
| 18. | Fran Gjonaj | Bred Limit | 0693170874 | | |
| 19. | Ramiz Smajlaj | Gruel e Re ~~0672512~~ 421 | | | |
| 20. | Viktor Gjonaj | Gruel e Re | | | |
| 21. | Ilumb Odeli | Xhan pult | | | |
| 22. | Aleksander Rrjku | Kir | 0685007771 | | |
| 23. | Gezim Corimo | XHAN | | | |
| 24. | Eduard Dogaj | PLAN | 0674937016 | | |
| 25. | Ylber Tahiri | Rrethina | | | |
| 26. | Jaylow Nualey | Shkole | | | |
| 27. | Bledar Plori | Rrethinat | 0692569219 | bledarplori@yahoo.com | |
| 28. | Frane Kola | Bashkia Shkoder | 0692549880 | | |
| 29. | Vilson Peshkaj | Bashkia Shkoder | 0688757213 | | |
| 30. | Paulin Gjoni | Rrethinat | 0682517410 | | |
| 31. | Moishe Jodokul | Bashki Shkoder | 0697714196 | | |
| 32. | Gjoralin Ndreu | Rrethina | 0694140348 | | |
| 33. | Vlatbardh Dama | Rrethina | 0692506382 | | |
| 34. | Erzen Tahoj | Rrethina | 0695444552 | | |
| 35. | Adrian Hasaj | Rrethina | 0693436715 | | |
| 36. | Ymet Rahova | SHKODER | | | |
| 37. | Arjet Rahova | B. SHKODER | 0696772399 | | |
| 38. | Rezmil Hasaj | RRETHINA | | | |
| 39. | Met Hasaj | GOLEM | 0677143433 | | |
| 40. | Arsell Hasaj | Golem | 0696504268 | | |
| 41. | Nolac Kocela | GRUEMIRE | | | |
| 42. | Vinton Shelqy | DPMOP | 0696411334 | | |
| 43. | Doner | Ura Namuna | 0685866S | | |
| 44. | PREKE FOÇAJ | Gjuhe e Re | 0683422331 | | |
| 45. | Nolue Dodaj | Hot Ri | 0682073127 | | |
| 46. | Alban Selija | B. Shkoder | 0672082858 | albanselija@yahoo.com | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 47 | Jozef Nolaj | B. Shkodër | 0682458721 | nolaj.jozef@gmail.com | |
| 48 | Mëhmet Shtegu | Dobraç | 0673921058 | | |
| 49 | Saber Selfko | | | | |
| 50 | Shend e Syzoj | Golem | | | |
| 51 | | Golem | | | |
| 52 | Lytfi Hoxhiqe | Shtoj i Vjetër | | | |
| 53 | [illegible] | Grudë e Re | | | |
| 54 | ARDIAN TROJA | GOLEM | | | |
| 55 | ARBEN MANUSHI | GOLEM | | | |
| 56 | Mirela Metaj | Shtoj i Ri | 0 | | |
| 57 | Mojriz Dehovi | SHtoj i Ri | | | |
| 58 | Rozina Stakaj | Grudë e Re | | | |
| 59 | [illegible] Lekaj | Shtoj i Ri | 0672831678 | | |
| 60 | Mirela Bujkoj | Golem | | | |
| 61 | Lindita Haxhiaj | Golem | | | |
| 62 | Saime Kopreqi | dr. Shtoj i Ri | 0696986185 | saime.kopreqi@hotmail.com | |
| 63 | Anxhiona Kulbregi | Shtoj i Ri | 0682282588 | | |
| 64 | Edmira Dani | Dobraç | 0682304996 | | |
| 65 | [illegible] | Dobraç | 0696196904 | | |
| 66 | Ermira Celiku | Dobraç | 0674041350 | ermira.celiku@hotmail.com | |
| 67 | Irma Coku | Grudë e Re | 0683455316 | irma.coku@gmail.com | |
| 68 | Arione Nikolli | Grudë e Re | 0692052656 | ariona.78@hotmail.com | |
| 69 | [illegible] | Dobraç | 0684488893 | Kryetar i fshatit [illegible] | |
| 70 | [illegible] | Hotit | | | |
| 71 | [illegible] | Zues | 0652341608 | | |
| 72 | Barhom Erkozi | Zues | 0672854382 | | |
| 73 | | | | | |
| 74 | [illegible] | Bretkina | 0692388884 | | |
| 75 | Mhill Bregu | Bretkina | Bleram 0682274464 | | |
| 76 | [illegible] | Bretkina | 0672556631 | | |
| 77 | Orbid Pironi | Bucieke | 0688805808 | orbidpironi@gmail.com | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 78 | HDOC FUSHA | KRYTARI.FSATIT.BLERAN/ | 0693833337 | | |
| 79 | Dritan Aliijo | Kryetar Fshati | 0692259645 | | |
| 80 | Qazim Nofo | Sr. DPM Bellune | 0671455560 | | |
| 81 | Klajdi Qahi | Dr. Q.Sh. Brethinat | 0698550026 | | |
| 82 | Ebetino Delcovi | QSh Recepsioniste | 0693318082 | | |
| 83 | Fatjona Jahiqi | Infermiere Q.SHRRETHINA | 0676368116 | | |
| 84 | Meta Memco | MRF Dobrac | 0675058566 | | |
| 85 | Rezarta Poole | Keshilltare PSD | 0692437830 | | |
| 86 | Gel Gjergjeqaj | Kryetari i Bordit Dobraç | | | |
| 87 | Arolt Toplay | | 0692595761 | | |
| 88 | Faulant Shahmani | Guci etc | 0699412247 | | |
| 89 | Eliane Shkreli | Keshilltare | 0674674786 | | |
| 90 | Jeris Vesha | Bashkia Shkoder | 0686545655 | | |
| 91 | Silvia Dizdari | | | | |
| 92 | Gelta Shahu | BASHKIA SHKODER | | | |
| 93 | HEKTOR NDREU | BASHKIA.SHKODER | 0674102200 | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

## PËR

## "DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR".

**Konsultim publik :** Njësia administrative Velipojw.

**Data :** *13.09.2024* **Ora** : *13.00* **Vendi:** Pranë Komunës

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesmarrësve 30, nga të cilat 4 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për drafi projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Zv/Kryetari i Bashkisw Shkodër, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :**

Fjalën e merr fillimisht **Kryetari fshati Ças,** i cili ndalet tek tre pika kryesore:

- Është bërë investimi për kanalet e para dhe të dyta por kemi nevojë për pastrime në kanalet e treat.
- Sa i përket ujrave të zeza nuk kemi kanalizime dhe është e nevojshme të kemi një rrjet kanalizimesh.
- Ka nevojë edhe për shtim ndriçuesish.

**Banor,** fshati Baks i Ri shprehet se nuk ka asnjë meter asfalt të shtruar . Në zonen e tij ka rreth 30 shtëpi dhe nuk ka asnjë investim në infrastrukturë.

**Z.Elez Sadiku ,** fshati Luarez thotë se:

- Ndriçim në lagje nuk ka, nuk kemi asnjë ndriçues.
- Në mes të fshatit kemi një rrugë të bllokuar dhe nuk mund të kalohet.

**Banor,** fshati Baks i Ri shprehet se:

- Kemi probleme me pajisjen me dokumentacionin e tokave.
- Kanalet janë të bllokuara, duhen pastruar.
- Të vendosen BUME pranë shkollës së mesme sepse ka shumë rrezikshmëri për femijët.
- Rrugicat pranë njësisë administrative janë të gjitha të prishura.
- Ndriçimi, ka nevojë per shtim të rrjeti.
- Duhen verifikuar kanalizimet e zonës.

Drejtori i shkollës "Gjergj Vate Martini", **Z. Agron Teli** thotë se:

- Siguria e transportit publik për femijet, nuk kanë ku ndalen furgonet pranë shkollës.
- Të krijohet për furgoëet nje stacion qëndrim.
- Të sigurohet një roje për shkollën, sidomos gjatë orarit të mësimit.
- Në Ças kemi një familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, a mund gjendet ndonjë mundësi për t'i ndihmuar dhe riparuar shtëpinë nga bashkia.
- Dera e shkollës ka dalje direkt në rrugë dhe ka rrezikshmëri për mbi 300 nxënësit e shkollës. Duhet të mendohet për një xhep për ndalimin e furgoneve.

**Kryetari** i fshatit Reç i Ri , shprehet se:

- Rruga është e pa asfaltuar krejtësisht, duhet përfunduar.
- Kemi probleme me dokumentacionin e pronësisë.
- Rruga është me gropa që krijojnë problem për banorët e zonës.
- Pranë rrugës gjithashtu ka nevojë të pastrohen ferrat dhe barishtet.

**Kryetari** i fshatit Rrjoll merr fjalën dhe thotë se:

- Ka nevojë të ndërtohen rrugët lidhëse me bregdetin.
- Problematikë mbeten kanalizimet e ujrave të zeza dhe ujësjellësi.

Ai gjithashtu pyet se çfarë mund të behet më shumë për t'i ardhur në ndihmë banorëve të zonave rurale?

Përgjigjet **Z. Onid Bejleri** se po miratohet ligji përsa i përket modeleve të shtepive dhe ndërtimeve që mund të bëhen në fshat me procedurë të përshpejtuar. Gjithashtu edhe për ndërhyrje të çative, mureve apo rrethimeve kemi thjeshtime në aplikimin dhe miratimin e ketyre lejeve.

**Banore**, fshati Baks i ri shprehet se në hyrje të rrugës duhet të vendoset vendoset nje pasqyrë sepse është zonë shumë e rrezikshme.

**Z.Gjovalin Ndoj** shprehet se në përgjithësi u përmenden problematikat e Velipojës por në Sektor Velipojë ka shumë nevojë për pastrim të bimësisë. Po ashtu lagjet në Velipojë qendër janë të gjitha me ujëra të zeza që dalin në asfalt sepse nuk ka kanalizime të ujrave të zeza.

**Kryetari i fshatit, Pulaj Plazh** shpreh shqetësimet e banorëve të zonës:

- Rruga nr. 8 ka nevojë për ndërhyrje në riparime gropash.
- Rruga nr. 10 ka një pjesë që ka nevojë për riparim.
- Pas rrugës 12 Velipoja është e pasistemuar dhe pa dalje në bregdet.

Z.Bejleri sqaron se Bashkia Shkodër është në faze të projektimit për rrugën paralele me pedonalen si dhe rrugët vertikale që lidhin me bregdetin.

**Z.Pjerin Jakaj**, banor shprehet se:

Në zonën e plazhit puna për mirëmbajtjet duhet të fillohet shumë me herët.

- Puna në terren, pastrimet, tualetet publike, lulishtet, ndriçimi etj duhet të sistemohen para se të fillojë sezoni.
- Është shumë urgjent përfundimi i pedonales si për rastet e emergjencës ashtu edhe për akses të turistëve.
- Edhe ndarja e parcelave të plazheve të bëhet në kohë.

Megjithatë shton ai, është me rëndësi të vlerësojmë punët që janë bërë deri tani përsa i përket investimeve dhe mirëmbajtjes së Velipjës.

**Zv/kryetari Rudin Beka** merr fjalën dhe thotë se është me rëndësi të rrisim bashkëpunimin midis dy paleve Bashkisë dhe bizneseve sepse nga kapaciteti i madh që ka Velipoja, vetëm një pjesë paguajnë taksat dhe tarifat të cilat mund të përkthehen në investime. Duhet të mblidhemi në kohe dhe të krijojmë mundësinë që të kemi sezon përgjatë gjithë vitit.

**Znj. Rezarta Pode,** anëtare e Këshillit bashhkiak shprehet se në kuadër të sugjerimeve, rekomandoj që pranë vendeve ku ka thellësi të vendosen tabelat. Gjithashtu në fillim sezoni duhet të ketë të vendosura bova dhe kanalet e kalimit të motorreve të ujit.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

Zbardhi proces verbalin:

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

**Sabina Danaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

## LISTË PREZENCË

**DËGJESË PUBLIKE: Për draftin e Projekt Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër"**

***Njësia Administrative Velipojë***

***Datë:*** **13.09.2024**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Violeta Perpaliecaj | Velipojë | | | |
| 2 | Rezarta Gjoleli | – | 0692437830 | | |
| 3 | Riona Shkrela | – | 0673150889 | | |
| 4 | | | 0674674716 | | |
| 5 | Gjergji Malaj | Velipojë | 0693435737 | | |
| 6 | | | | | |
| 7 | Fran Pemaku | | 0682085193 | | |
| 8 | Lucia Preloca | | 0674743344 | | |
| 9 | Gjoni Prendaj | | [illegible] | | |
| 10 | Ndok Sokolaj | Reç | 0692529086 | | |
| 11 | Genin Tolig | Fushë Ploshe | 0642348222 | | |
| 12 | Artan Zoçkh | Luarzë | 0677010503 | | |
| 13 | Simon Dodaka | Gomsiqe | 0682264836 | | |
| 14 | Agron Teli | Shkodër | 0673858449 | | |
| 15 | ENIS Ramaj | Baks Ri | 0673890184 | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 16. | [illegible] Rumaj | Baks Ri | 0682473090 | | |
| 17. | Arben Gjergji | Rec Vjeter | 067323804 | | |
| 18. | Ferdinand [illegible] | G.B.[illegible] | 0689730832 | | |
| 19. | Alban Shkjez | B. Shkoder | 0672082858 | | |
| 20. | Flavio Malocaj | Dr. Nd. Ekonomike B.SH | 0684063501 | | |
| 21. | SANDER NACUNI | BAKS - PEZOLL | 0676158021 | | |
| 22. | EDUARD KOLA | ÇAZ | 069 2925732 | | |
| 23. | Kreshnik Ramaj | Baks i R. | 0672579676 | | |
| | | | | | |
| 24. | FLORIAN TOMA | GOMSIÇE | | | |
| 25. | Zybe Aluma | [illegible] Velipoje | 0674431849 | zybedalima@yahoo.com | |
| 26. | Anton Marku | Velipoje | 0674060217 | markuanton1960@yahoo.com | |
| 27. | Francesk Lulaj | Pulaj - Velipoje | 0673071857 | | |
| 28. | Arjan Gjendrecaj | Gomsiqe | 0682078008 | | |
| 29. | Adrian [illegible] | BAKS | 0696808808 | | |
| 30. | [illegible] [illegible] | Baks i Ri | 06767064[illegible] | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |